

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

Raporti Vjetor i Auditimit
Godišnji Izveštaj Revizije
Annual Audit Report
2009

Prishtinë, 31 Gusht 2010



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL

Raporti Vjetor i Auditimit për vitin financiar 2009

Prishtinë, 31 Gusht 2010

PËRMBAJTJA

Shkurtesat

Fjala e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e Përgjithshme ..... i-viii

1 Hyrje 1
2 Auditimi i Jashtëm dhe Llogaridhënia 3
3 Raporti Vjetor Financiar për Qeverinë 7
3.1 Hyrje 7
3.2 Qasja e Auditimit 7
3.3 Rishikimi Analitik 8
3.4 Opinioni i Auditimit i AP-së mbi PF- të e Konsoliduara 15
4 Performanca Financiare e Organizatave Buxhetore 17
4.1 Hyrje 17
4.2 Veprimet për rekomandimet paraprake të auditimit 18
4.3 Pajtueshmëria në zbatimin e buxhetit 19
5 Menaxhimi Financiar 21
5.1 Politika e KBFP-së 21
5.2 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit 22
5.3 Raportimi 23
5.4 Korniza Ligjore e MFK-së 23
5.5 Reformat 23
5.6 Certifikimi 23
5.7 Njësitë Qendrore Harmonizuese 25
5.8 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm 26
5.9 Prokurimi 28
5.10 Burimet Njerëzore 31
5.11 Menaxhimi i Pasurisë Fikse 33
5.12 Paraja e imët (Petty Cash-i) 35
5.13 Auditimi i Brendshëm 36
6 Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore 41
7 Institucionet e Pavarura 47
8 Komunat 51
8.1 Hyrje 51
8.2 Qeverisja lokale dhe përgjegjësitë 52
8.3 Financimi i komunave 52
8.4 Zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar 53
8.5 Gjetjet kyçe të auditimit 54
8.6 Konkluzionet përfundimtare 55

Shtojca
Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400) 59
Opinionet e Auditimit dhe mangësitë kryesore menaxheriale 61

Lista e shkurtesave

AP	Auditori i Përgjithshëm
AAK	Agjencia Kundër-Korrupsionit
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DK	Doganat e Kosovës
DUD	Dokumenti Unik Doganor
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik
KA	Komisionet e Auditimit
KBFP	Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
KFK	Korporata Farmaceutike e Kosovës
LP	Libri i Përgjithshëm
LMFPP	Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji për Prokurim Publik
KRPP	Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik
MKF	Menaxhimi dhe Kontrolli Financiar
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MAPL	Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MFPP	Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MFSK	Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
MAP	Ministria e Administratës Publike
NJQH/MFK	Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhim Financiar dhe Kontroll
NJQH/AB	Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditim të Brendshëm
NjAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OB	Organizatat Buxhetore
PF	Pasqyrat Financiare
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RVA	Raporti Vjetor i Auditimit i Auditorit të Përgjithshëm
RVP	Raporti Vjetor i Punës së Auditorit të Përgjithshëm
SIMFK	Sistemi Informativ Menaxherial Financiar i Kosovës
SIGTAS	Sistemi i Administratës Tatimore
TIMS	Sistemi për Menaxhimin e Informatave Tregtare
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UA	Udhëzimi Administrativ 2005/11
UNMIK	Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VF	Viti Financiar
ZKA	Zyrtari Kryesor Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Adresimi nga Auditori i Përgjithshëm



Të nderuar Anëtarë të Kuvendit,

Kam kënaqësinë e madhe që t'ju dorëzoj Raportin Vjetor të Auditimit të këtij viti. Ky raport përfshin implementimin që Qeveria i ka bërë buxhetit të vitit 2009 dhe Pasqyrat Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për të njëjtën periudhë.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm vazhdon me misionin e saj thelbësor për ti kërkuar llogari organeve shpenzuese por ky raport flet edhe për tema të zakonshme të cilat i mbështesin këto organe për tu përmirësuar. E vërteta është se, përveç progresit të bërë, organet që ne i auditojmë kanë shumë fusha në të cilat kanë nevojë për përmirësim. Aty ku kemi gjetur mangësi ne kemi dhënë rekomandime konstruktive për ndryshim. Strategjia ime ka qenë që të siguroja se programi ynë i punës fokusohet në ato fusha ku kërkohet ndryshimi, qoftë në fushën e kontrollit të brendshëm, pajtueshmërisë me rregulloret, apo në çështje rreth vlerës së parasë. Ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë me organet e audituara, duke vepruar kështu si drejtuesit kryesor të ndryshimit në sektorin publik.

ZAP është e pajisur mirë për të kryer këtë program ambicioz. Ne kemi punuar ngushtë me Kuvendin në mënyrë që të zgjeronim kapacitetin tonë për të dhënë informacion cilësor mbi përdorimin fondeve publike dhe për ti shtuar vlerën funksionimit efikas dhe efektiv të autoriteteve publike. Bashkëpunimi ynë me Qeverinë në zhvillimin e qasjeve për ndërtimin e qeverisjes së mirë dhe sistemeve më të mira për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin është zhvilluar gjithashtu.

Ky raport nxjerr në pah, me fjalë të qarta dhe të ndershme, fushat ku ne të gjithë duhet luajmë pjesën tonë për të shtyrë përpara përmirësimet në sektorin publik. Shpresoj që ai do t'ju shërbejë si një mjet i dobishëm për identifikimin e fushave ku ne të punojmë të gjithë së bashku për të mirën e sektorit publik dhe të qytetarëve të Kosovës.

Unë e lëvdoj këtë raport tek anëtarët e nderuar dhe pres me padurim diskutimet dhe përgjigjet tuaja.

Prishtinë, 31 Gusht 2010

Lars Lage Olofsson
Auditor i Përgjithshëm

Përmbledhje e Përgjithshme

Opinioni im i përgjithshëm për Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF-të) të Qeverisë për BKK-në 2009 është se në aspektin material ato janë:

- Në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe me Udhëzimet e zbatueshme Administrative;
- Në pajtim me SNKSP-në; dhe
- Paraqesin pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të BKK-së.

Kështu që ky është një "Opinion i pakualifikuar" në harmoni me Standardet e Auditimit të pranuara ndërkombëtarisht nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI400 cf. Shtojca 1).

Megjithatë, ekzistojnë disa mangësi në proceset e raportimit, të cilat nuk janë aq shumë të rëndësishme sa të ndikojnë në cilësinë e informacionit në përgjithësi.

Ekzistojnë ndryshime mes PF të organizatave buxhetore individuale dhe PF të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për sa i përket raportimit të pasurive jo financiare, detyrimeve të papaguara, dhe avanseve.

Shifrat nuk ishin barazuar mes sistemit të listës së pagave dhe Librit Kryesor të Thesarit për sa i përket pagave. Një numër organizatash buxhetore i paguajnë pagat nga të hyrat e tyre dhe një pjesë e pagave paguhen drejtpërdrejtë nga Thesari.

Ekzistojnë shumë raste të pamjaftueshmërisë në prezantimin e pasurive lidhur me vlerën financiare dhe ekzistimin e tyre.

Të hyrat regjistrohen në një mënyrë të rregullt dhe korrekte, me përjashtim të disa mangësive lidhur me:

- Barazimet me kohë mes organizatave buxhetore dhe Thesarit;
- Mos regjistrimin e transaksionit në kodet e duhura ekonomike; dhe
- Mungesën e aktiviteteve për sa i përket grumbullimit të të hyrave; dhe
- Në disa prej komunave ekzistojnë probleme të kontabilitetit në përgjithësi.

Ekzekutimi i buxhetit ende është në një nivel të pakënaqshëm, sidomos kur kemi të bëjmë me buxhetin për projektet kapitale. Kjo ka qenë si rezultat ose i vonesave në implementimin e projekteve të ndryshme ose i dështimit të tyre.

Instrumentet financiare qeveritare të depozituara në BQK dhe në bankat komerciale nuk janë shpalosur aq qartë sa duhet në PVF të BKK-së. Mënyra se si janë prezantuar nuk jep informacion të mjaftueshëm as për sa i përket llojit të investimeve as rezultateve nga to.

Mënyra se si janë menaxhuar dividendat e PTK-së mund të ishte shpalosur më mirë në pasqyrat financiare, duke shpjeguar qëllimin për deklarimin, proceset që janë përdorur, dhe rezultatet financiare nga dividendat e investuara.

Ekzistojnë gjithashtu të meta në lidhje me shpalosjen e detyrimeve të papaguara për faktin se disa organizata buxhetore nuk i kanë dorëzuar PVF-të e tyre me kohë apo nuk i kanë dorëzuar fare, si dhe për shkak të veprimit të pamjaftueshëm të marrë nga Thesari.

Ne kemi qenë në gjendje të japim një opinion mbi pasqyrat financiare të BKK-së si rezultat i punës sonë audituese në organizatat kryesore buxhetore. Ne kemi dhënë 66 opinione në PVF-të e organizatave buxhetore për vitin 2009 – duke mbuluar 95% e të hyrave dhe 80% të shpenzimeve si totale të konsoliduara në pasqyrat financiare të BKK-së. Përveç kësaj, ne kemi kryer pesë lloje të ndryshme të auditimit të cilët nuk kanë përfunduar me opinione mbi pasqyrat financiare.

Nga auditimet tona të *PVF*-ve të shpenzuesve individual të buxhetit kemi dhënë opinionet e auditimit si në vijim:

- Pesëmbëdhjetë të Pakualifikuara;
- Gjashtëmbëdhjetë të pakualifikuara me Theksim të Çështjes;
- Katër të Kualifikuara;
- Njëzet e nëntë Mohime të Opinionit; dhe
- Dy Opinione të Kundërta.

Ekzekutimi i buxhetit

Shkalla e përputhshmërisë mes ligjeve dhe rregulloreve nuk është e kënaqshme. Shkaqet kryesore për këtë janë:

- Mungesë e të kuptuarit të menaxhmentit mbi përgjegjësitë e tyre themelore në bazë të ligjit;
- Mungesë e të kuptuarit më të thellë të dizajnit dhe qëllimit të sistemeve themelore të MFPP;
- Mungesë e njohurive se si trajtimet e kontabilitetit, ligjeve dhe rregulloreve bashkëveprojnë; dhe
- Harmonizimi i dobët i ligjeve dhe rregulloreve që shpien në kontradikta dhe paqartësi.

Ka nevojë për udhëzime, shembuj të praktikës së mirë dhe forma të tjera për të mbështetur këto fusha. Unë parashoh se Njësia Qendrore e Harmonizimit për Menaxhimit Financiar dhe Kontroll (NJQH / MFK) do t'i shqyrtojë këto mangësi dhe do të merr masa të duhura për t'i adresuar ato.

Do të doja të tërheq vëmendjen tuaj për disa çështje të veçanta shqetësuese në vijim:

- Shpenzimet kundrejt ndarjeve përfundimtare buxhetore ishin më mirë se vitin e kaluar, por ende papranueshëm ulët. 86,5 % të buxhetit përfundimtar të Organizatave Buxhetore është shpenzuar gjatë vitit 2009. Planifikimi i Buxhetit, monitorimi dhe ekzekutimi duhen të përmirësohen;

- Organizatat Buxhetore ende janë duke rritur shpenzimet e tyre në mënyre dramatike gjatë fundvitit – duke rritur gjasat që shpenzimet do të jenë të rastit dhe do të pasqyrojnë vlerë të vogël për para.
- Trajtimi i pasurive jo-financiare në PVF tek shumica e Organizatave Buxhetore është i dobët dhe nuk është përfundimisht sipas standardeve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 2005/11 për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive të Qeverisë. UA duhet të zbatohet më mirë në nivelin qendror; dhe
- Ekziston nevoja për përmirësim të konsiderueshëm në trajtimin e prokurimit në shumicën e Organizatave Buxhetore.

Prokurimi

Llogaria e aktiviteteve të prokurimit përbën një vlerë të konsiderueshme të shpenzimeve publike. Sistemi i sektori të prokurimit publik nuk funksionon si duhet dhe ka një sërë mangësish.

Në këtë kuptim, proceset e menaxhimit të prokurimit nuk janë realizuar gjithmonë në përputhje të plotë me LPP, dhe ka pasur mangësi prej fillimit të proceseve deri në fazën e ekzekutimit të kontratave. Kjo paraqet rrezik që aktivitetet e prokurimit do të lejojnë vlerë të dobët për para.

Kontrollet në nivel menaxherial brenda organizatave buxhetore nuk janë zhvilluar sa duhet. Menaxherët e organizatave buxhetore nuk janë përfshirë sa duhet në zhvillimin e procesit të prokurimit për të siguruar zgjidhje me kosto të ulët dhe cilësi të lartë.

Për këtë qëllim, ideja e përgjegjshmërisë menaxheriale nuk është promovuar sa duhet në të gjithë sektorët e organizatave buxhetore.

Për këtë arsye, menaxherët duhet të kuptojnë më mirë se ata duhet të jenë llogaridhënës për përdorim ekonomik, efikas dhe efektiv të burimeve publike.

Unë rekomandoj Kuvendin që me kujdes të ndjek implementimin e Ligjit të ri të Prokurimit e veçanërisht:

- Mekanizmin me të cilin llogaridhënia dhe kontrolli funksionojnë. Detyra të qarta dhe theks mbi përgjegjësitë individuale do të sigurojë përdorimin efikas të parave publike;
- Transparencë dhe konkurrencë të barabartë e cila trajton të gjithë operatorët në mënyrë të drejtë dhe të barabartë;
- Se si sistemi siguron që Organizata Buxhetore ndjekin proceset e prokurimit siç është e përshkruar në kornizën legjislative, duke filluar nga fillimi i proceseve, deri tek firmosja dhe mbikëqyrja e kontratave; dhe
- Funksioni mbikëqyrës i implementimit të projekteve i cili duhet të sigurojë që mallrat, shërbimet apo punët e kontraktuar janë kryer në përputhje me sasinë dhe cilësitë kontraktuar.

Kontrolli i Brendshëm

Puna jonë audituese tregon se ka sfida në implementimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilat funksionojnë mirë. Ekziston një numër i madh arsyesh për këtë:

- Mungesë e të kuptuarit në mesin e menaxhmentit mbi parimet dhe praktikat e sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- Mospërputhje dhe paqartësi me kornizën legjislative; dhe
- Mungesë e të udhëzuarit në lidhje me këtë çështje dhe mungesë e shembujve të praktikës së mirë.

Një tjetër çështje shqetësuese është funksioni i Zyrtarit Certifikues (ZC), i cili në praktikë nuk ishte mjaft efikas në arritjen e qëllimeve. Si rrjedhojë, procesi nuk pengon kryerjen e pagesave të parregullta duke e marr atë si një element jo shumë të dobishëm të sistemit qeveritar të menaxhimit financiar dhe lë një barrë të madhe të rrezikut financiar për shtetin.

Roli i ZC-së ka nevojë për sqarim. pozitës së ZC-së duhet të rishikohet në zinxhirin e përgjegjësive dhe llogaridhënies në lidhje me vërtetimin e pagesave. Një rishikim i tillë duhet të bazohet në parimet dhe qasjet e përfshira në politikën e re të KBFP, në udhëzimet e Thesarit dhe rregullat financiare.

Ata që punojnë për zbatimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, deri më tani, i ka munguar elementi kryesor – i quajtur NJQH / KMF. NJQH / KMF synon të sigurojë që sistemet e qëndrueshme të menaxhimit financiar janë duke punuar për të forcuar praktikën e mirë në të gjithë sektorin publik. NJQH / KMF është themeluar dhe drejtuar tani. Ajo ka filluar të trajtojë kornizën legjislative dhe është duke testuar qasjet dhe metodat e reja.

NJQH / KMF duhet të jetë i rrënjosur në një përkufizim të gjerë të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Një politikë e re e KBFP është duke u hartuar bazuar në parimet e përshkruara në Politikën 2007 KBFP në të njëjtën kohë janë marrë parasysh edhe përvojat e fituara. Kjo do të mundësojë NJQH / KMF për të adresuar sfidat me të cilat është përballur.

Në fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit unë rekomandoj që të miratohet një zgjidhje me qasje të gjerë ku llogaridhënia menaxheriale është nxitur dhe menaxherëve do tu jepet qasje në një sërë materialesh mbështetëse. Këto materiale do të përfshijnë:

- Udhëzime mbi çështjet e përgjithshme të menaxhimit financiar;
- Krahasime mbi rezultatet e raportimit dhe rezultatet e operacioneve; dhe

Një suitë të formave të reja të raportimit sipas LMFPP të ndryshuar.

Auditimi i brendshëm

Raporti i dytë zyrtar qeveritar, i përgatitur nga NJQH / AB në MEF, për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik 2009 është dërguar në Kuvend në pranverën e vitit 2010. Konkluzioni kryesor i këtij raporti ishte se janë krijuar parakushte të nevojshme, janë vendosur më shumë auditorë të brendshëm dhe Komisione të Auditimit, Auditimi i Brendshëm nëpër organizatat buxhetore nuk ishte plotësisht funksional dhe se pritjet menaxhmentit për auditim të brendshëm ishin të ulëta.

Auditimi i brendshëm është duke u zhvilluar hap pas hapi. Funksioni i tij është forcimi i vazhdueshëm, pavarësisht nga dobësitë e shumta të kontrollit të brendshëm në menaxhimin e financave publike.

Deri më sot, fokusi kryesor ka qenë ndërtimi i kompetencave themelore të auditimit të brendshëm. Siç mund të pritet në këtë fazë të zhvillimit, në praktikë, ka mangësi të shumta. Planet e nxjerra të Auditimit të brendshëm janë shpesh të elaboruara në mënyrë të pamjaftueshme dhe nuk i përfshijnë qëllimet. Auditimet e kryera në praktikë janë ende të kryesisht përqendruara në transaksionet individuale dhe në pajtueshmëri. Theks i pamjaftueshëm i është dhënë qasjes orientuar drejt sistemeve, drejtuar me materialitet, qasjes bazuar në risk. Në një masë të madhe auditimi i brendshëm është i përqendruar në vitin e kaluar dhe për shkak të kësaj ne nuk jemi ende në gjendje të mbështetemi në punën e NJAB-së për të fituar siguri të auditimit mbi cilësinë e PVF. Me pak fjalë, funksioni ende ka për të vërtetuar vlerën e saj praktike të menaxhimit.

Ne gjithashtu theksojmë se krijimi i Komisioneve të Auditimit (KA) duket të jetë mbetur prapa. Kemi një mendim që krijimi i auditimit të brendshëm, si dhe një KA në organizatë buxhetore të vogël nuk është i mjaftueshëm dhe tepër i kushtueshëm. Një dritare është hapur për shërbimet e ndara në këto raste. E në praktikë, nuk përdoret ende.

Të gjeturat tjera të përgjithshme

Do të doja të tërheq vëmendjen tuaj për disa çështje të veçanta me interes së bashku me rekomandimet e mia:

- Trajtimi i Burimeve Njerëzore dhe sistemet e pagave janë aspekte të rëndësishme në përpjekje që të përmbushen objektivat dhe për të zhvilluar qeverisje të mirë. Trajtimi i BNj-ve duhet ndryshuar në shumë mënyra pas kornizës së re legjislative. Pritjet publike në nivelin e shërbimeve do të vazhdojnë të rriten. Institucionet duhet të jenë në gjendje të vazhdojnë të tërheqin njerëz të talentuar dhe të përkushtuar qe do të jenë në gjendje për të dhënë vlerë për para. MAP është përgjegjës për mbikëqyrje dhe asistencë të reformimit në fushën e përmirësimit të sistemeve, shkathtësive dhe aftësive për të siguruar shërbimet e duhura dhe të përshtatshme publike. MAP duhet të:
- Forcojë rutinë mbi kontrata me paga; dhe
- Forcojë procedura të saja për të ekzekutuar dhe monitoruar pagesat e pagave;
- Prezantimi jo i duhur dhe i pasaktë i pasurive jo-financiare në PF të organizatave buxhetore dhe në PF të BKK-së ka rezultuar në nënvlerësim material të pasurive në pronësi publike. Për të mbrojtur pasuritë publike unë rekomandoj Kuvendit për të kërkuar që Qeveria të marrë masat për të siguruar që këto lloje të pasurive trajtohen me kujdes dhe se çështja e pronësisë do të trajtohen siç duhet. Në të njëjtën kohë Qeveria gjithashtu duhet të sigurojë raportim të plotë dhe të saktë në të gjitha nivelet e këtyre pasurive; dhe
- Organizatat buxhetore nuk janë ende duke vepruar sa duhet në lidhje me të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit nga ana e ZAP-it. Unë nuk jam i kënaqur me përparimin e Organizatave Buxhetore në adresimin e rekomandimeve tona. Kjo duhet të trajtohet në të gjitha nivelet e

llogaridhënies. Kuvendi duhet të shtyjë Qeverinë që të sigurojë që të merren masa mbi të gjeturat dhe rekomandimet e auditimit nga ZAP-i në mesin e Organizatave Buxhetore. Qeverisë duhet t'i kërkohet, si çështje urgjente, për të vendosur një sistem ku gjetjet dhe rekomandimet e ZAP-it janë shqyrtuar dhe janë marr masa në lidhje me to.

Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore

Kemi audituar dy Ndërmarrje Publike Shoqërore (NPSH) Qendrore dhe dy NPSH Lokale. Auditimi ynë i NP-ve zbuloi një numër të metash në lidhje me kërkesat ligjore, monitorimin, raportimet e brendshme dhe ato të jashtme, inkasimin e mjeteve, trajtimin e borxhit etj.

Auditimet tona tregojnë se Qeveria nuk e monitoron punën e NP-ve në mënyrë adekuate dhe NP-të nuk janë të menaxhuara në nivel të kënaqshëm. sisteme të dobëta të kontrollit, humbje të vazhdueshme operative dhe mbledhjen e pamjaftueshme të borxheve të papaguara që çon në rreziqe të panevojshme financiare për qeverinë në lidhje me NP-të.

Informata e mbledhura vjetore mbi Ndërmarrjet në Pronësi Publike janë joadekuate. Pa një informacion të mirë, Qeveria nuk është në gjendje të kuptojë performancën e NP-së ose të kuptoj dhe të menaxhoj rrezikun e përgjithshëm fiskal.

Qeveria ka dështuar të monitorojë rreziqet financiare të NP-ve dhe nuk ka ndërmarr masa të nevojshme në përputhje me parimet e transparencës, qeverisjes dhe llogaridhënies, në përputhje me përgjegjësitë e saja ndaj NP-ve.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është përgjegjëse për administrimin dhe privatizimin e NSH-ve.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare AKP-së për 2009, dhe kemi kryer një auditim të posaçëm të pasqyrave financiare të Fondit të Privatizimit për periudhën 1 tetor 2007 deri më 31 dhjetor 2009.

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare të Fondit të Privatizimit ka gjeneruar të gjetura dhe konkluzione për administrimin dhe privatizimin e NSH-ve nga ana e AKP-së. Në kuadër të menaxhmentit të fondit ka dobësi në monitorimin e ndërmarrjeve të privatizuara me Spin-off special, si dhe vonesat në përfundimin (firmosje) të kontratave. Dobësi të mëtejshme janë identifikuar në lidhje me konfliktin në mes të politikave që vepron AKP-ja dhe rregullat e tenderit, si edhe dobësi në sistemet e kontrollit të brendshëm.

Rekomandoj Kuvendin:

- Që të përcjell ngushtë se si Qeveritë, p.sh MEF e kryen rolin e saj si përfaqësuese e pronarëve në NP;
- Të shqyrtoj masat që sigurojnë përputhshmërinë në mes të kërkesave të LMFPP dhe Ligjit për ndërmarrje publike, dhe
- Të konsideroj ndryshim në Ligjin e NP-ve duke siguruar që përfaqësuesi i pronarit të caktoj auditorë të jashtëm në ndërmarrjet individuale.

Institucionet e pavarura

Institucionet e pavarura që ushtrojnë funksionet rregullatore dhe mbikëqyrëse janë thelbësore për ndërtimin e demokracisë në Kosovë. Pavarësia e tyre duhet të sigurohet dhe në të njëjtën kohë menaxherët duhet të jenë llogaridhënës për mënyrën se si ekzekutohet buxheti.

Institucionet e pavarura përballen me një numër sfidash të përbashkëta lidhur me pavarësinë e tyre, përgjegjësitë e tyre dhe procesin e buxhetimit.

Rekomandoj Kuvendin:

- Të luaj një rol më të madh në mbikëqyrjen e zbatimit të kornizës ekzistuese legjislative të institucioneve të pavarura;
- Të emëron me kohë bordet apo kryesuesit e institucioneve dhe të sigurohet që të kanë nivel të lartë të kualifikimit dhe të jenë të pavarur;
- Të merr rol më aktiv në shqyrtimin dhe miratimin e raporteve vjetore të institucioneve të pavarura;
- Të iniciojë një studim se si organizohet mbështetje administrative institucioneve të pavarura duke siguruar cilësi në shërbime administrative; dhe
- Të hartohet korniza legjislative për institucionet e pavarura për të përcaktuar kriteret që do të garantonin pavarësinë e tyre, specifikimin e kërkesave të llogaridhënies.

Komunat

Auditimi ynë i komunave në përgjithësi jep një pamje të zymtë në lidhje me cilësinë e raportimit të jashtëm të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Raportet e auditimit të përfshijnë rekomandime në lidhje me të gjeturat e auditimit. Rekomandimet janë dhënë për të ndihmuar komunat të përmirësohen. Për fat të keq, shumica e rekomandimeve tona nuk janë duke u zbatuar. Dobësi të njëjta janë duke u përsëritur nga viti në vit; me rezultat që menaxhimi i financave publike është duke u përmirësuar shumë ngadalë.

Përveç këtyre dobësive të menaxhimit, ka edhe mangësi të shumta në fushën e raportimit nga komunat.

Metoda dhe mjetet e tjera duhet të merren parasysh për të siguruar një raportim më të mirë të jashtëm dhe MF/K në Komuna. Praktikat aktuale rrezikojnë efikasitetin e delegimit të kompetencave.
Në mënyrë që të sjellë një përmirësim të përgjithshëm të financave vendore publike, Qeveria është rekomanduar që të marrë një sërë masash për të siguruar raportimin më të mirë të jashtëm dhe të menaxhimit më të mirë financiar:

Rekomandoj Kuvendin të konsideroj:

Një dëgjim të veçantë me Ministrin e MEF-it dhe Ministrin e MAPL lidhur me nevojën e një Plani specifik të Veprimit për të fuqizuar raportimin e jashtëm dhe menaxhimin financiar në

komuna në përgjithësi dhe se si komunat e reja duhet të ndihmohen në kopjimin e kërkesave financiare.

Komentet e Qeverisë për RVA-në

Duke ndjekur praktikat e mira Evropiane, kam kërkuar nga Qeveria të komentoj në lidhje me RVA. Ministri i Ekonomisë dhe Financave ka ofruar me 17 gusht 2010 komentet e tij dhe ato të Qeverisë, si vijon:

Komentet, së bashku komente të tjera jo formale, janë përfshirë në raportin final.

1 Hyrje

Ne kemi nxjerrë këtë Raport Vjetor të Auditimit (RVA) i cili paraqet përmbledhje gjithëpërfshirëse dhe analitike mbi gjetjet dhe rekomandimet tona të auditimit për vitin financiar (VF) 2009. Auditori i Përgjithshëm (AP) në këtë raport shpreh Opinionin e Auditimit (në përputhje me ISSAI 400) *për Pasqyrat Financiare të Qeverisë së Kosovës për VF 2009.*

Ky përbën një dokument shumë të rëndësishëm në procesin e përgjegjësisë politike dhe atë administrative të cilin AP ia dorëzon Kuvendit. Dorëzimi i këtij raporti brenda afatit të paraparë më ligj i jep mundësinë Kuvendit të kërkojë llogari nga Qeveria për përgjegjësitë e saj politike dhe administrative në kohën e duhur.

Kryesisht në këtë raport (RVA) ne adresojmë raportin e BKK-së të Qeverisë, por edhe të gjeturat dhe konkluzionet tona janë të ndërlidhura me raportet e auditimeve të kryera mbi raportet e shpenzuesit buxhetor[1]. Gjithashtu unë i ndërlidh të gjeturat dhe konkluzionet e mia me raportet e progresit për sa i përket sistemeve të Auditimit të brendshëm dhe prokurimit. Më herët keni pranuar raporte prej Qeverisë në lidhje me këto çështje.

Më tutje, kemi nxjerr disa konkluzione të përgjithshme nga auditimet tona të jashtë buxhetit të BKK-së: disa auditime të ndërmarrjeve publike dhe auditimi jonë i performancës janë kryer.

Ne kemi marrë komente nga Qeveria mbi draftin e RVA-së të dorëzuar me 31 korrik 2010. Komentet, së bashku me komente të tjera jo formale, janë integruar në raportin final.

1 Raportet mbi auditimin tonë të shpenzuesve buxhetor mund ti gjeni në faqen tonë zyrtare: www.ks-gov.net/oag

2 Auditimi i Jashtëm dhe Llogaridhënia

Roli i ZAP-it në procesin e buxhetit në radhë të parë është, që t'i jap Kuvendit një prapaveprim të pavarur për përgjegjësitë e Qeverisë për sa i përket politikave fiskale dhe të shpenzimeve si dhe implementimin e tyre. Por ne gjithashtu duhet t'i sigurojmë Qeverisë dhe shpenzuesve të buxhetit një vlerësim të pavarur të operacioneve të tyre e gjithashtu edhe publikut. Do ta bëjmë këtë duke përdorur Auditimet e obligueshme Vjetore të Rregullsisë së ekzekutimit të buxhetit të BKK-së dhe disa institucione publike jashtë buxhetit të BKK-së, por edhe duke kryer auditime të performancës për ekonominë, efikasitetin dhe efektivitetin e operacioneve dhe shërbimeve qeveritare.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Financiare dhe evidencave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje *të drejtë dhe të vërtetë të* llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që merren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtruar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Auditimi i Përformancës përkufizohet si auditim i ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit të cilat entiteti i audituar i shfrytëzon resurset për arritjen e synimeve të veta. Ajo ka për synim rritjen e efektivitetit të subjekteve shtetërore dhe programeve duke përdorur standarde dhe praktika të auditimit të vendosura dhe të shpjeguara qartë.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për Pasqyrat Financiare të institucioneve të audituara, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë *opinion i pakualifikuar ose opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes, përkatësisht opinion i kualifikuar, opinion i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (*Cf Shtojca 1; ISSAI400).

Duke i respektuar afatet tona kohore që ti shtojmë vlerën e plotë rolit tonë ligjor dhe atë të auditimit, ne i kemi dhënë mundësinë Kuvendit që të mbyll zinxhirin e llogaridhënies ashtu siç është edhe përcaktohet. Do të fuqizojë transparencën e procesit të llogaridhënies nëse pikëpamjet e Kuvendit për këto çështje formulohen si direktiva për Qeverinë. Sipas ndryshimeve në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) Qeveria ka për obligim t'i

raportoj Kuvendit për veprimet e ndërmarra në lidhje me rekomandimet e AP-së dhe direktivave të Kuvendit.

Forcimi i përgjegjësive të menaxhmentit të lartë

Paratë publike duhen të përdoren vetëm për qëllime të miratuara. Asnjë shfrytëzues i buxhetit nuk duhet të devijojë, zbatojë në mënyrë të gabuar, ekspozojë apo të përdorë paratë publike në mënyrë të parregullt.

Shpenzimi i parave publike mund të bëhet vetëm nga fondet e ndara dhe të alokuara si dhe vetëm në përputhje me proceset e themeluara në bazë të LMFPP-së.

Të gjithë shpenzuesit buxhetor janë përgjegjës që të sigurojnë mënyrën më efikase, transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike sipas kushteve, rregullave dhe procedurave të rregulluara me ligj.

Ministri (ose Zyrtari Kryesor Administrativ [ZKA] në Organizata tjera Buxhetore) do të ushtrojë mandatin e tij në përputhje me ligjet në fuqi kur kanë të bëjnë – në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë - me paratë dhe burimet publike.

Ministri/ ZKA do të:

a) Udhëheq dhe përfaqësojë organizatën e tij/saj;
b) Jetë i përgjegjshëm ndaj Kuvendit[2];
c) Vendos direktiva të politikave;
d) Nxjerr vendime dhe udhëzime administrative për të rregulluar aktivitetet në përgjithësi ose fushat e caktuara të aktivitetit të tij;
e) Zbatoj kontrolle të brendshme të nevojshme; dhe
f) Në mënyre periodike, zakonisht përmes Qeverisë t'i raportoj Kuvendit, si dhe të raportoj për kërkesat e Kuvendit përfshirë përdorimin e të gjitha fondeve të pranuara.

Në kuadër të ministrive, operacionet e përditshme të deleguara Sekretarit Permanent janë si në vijim:

a) Administrimi dhe menaxhimi i përgjithshëm i ministrisë ose agjencisë ekzekutive dhe të sigurojë implementimin e funksioneve të besueshme;
b) Dhënien e udhëzimeve të besueshme dhe të drejta, dhënien e këshillave të paanshme dhe profesionale, për autoritetin përkatës që është mbi të;
c) Personeli dhe organizimi i ministrisë ose agjencisë ekzekutive dhe për nxjerrjen e vendimeve dhe udhëzimeve administrative në të gjitha rastet ndërlidhet me funksionet e tij;
d) Menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve të cilat u janë dhënë ministrisë apo agjencisë ekzekutive;
e) Sigurimin e një kontrolli të brendshëm, transparente dhe efikase, dhe auditim të brendshëm të operacioneve dhe financave; dhe
f) Të sigurojë që personeli në ministri apo agjenci ekzekutive është punësuar në bazë të kualifikimit profesional, me kompetencë dhe meritë përmes konkurrimit të drejtë dhe të hapur.

2 Në Komuna, Kryetari i Komunës i jep llogari Kuvendit Komunal, por edhe para Kuvendit të Kosovës kur bëhet fjalë për shpenzimin e buxhetit shtetëror.

Në këtë mënyrë, Ministri, e gjithashtu ZKA, mund ti delegojnë përgjegjësitë por, ai/ajo nuk mund asnjëherë të delegojnë llogaridhënien. Për shkak të delegimit të përgjegjësisë të çështjeve kryesore administrative, rregulloret financiare imponojnë *përgjegjësinë Sekretarit Permanent që të zbatojë kontrolle të brendshme dhe mekanizma të llogaridhënies. Sidoqoftë, Ministri e ka përgjegjësinë përfundimtare* për të përdorur autoritetin e tij/saj për menaxhimin e ministrisë në rastet kur ai/ajo konsideron se Sekretari Permanent nuk mund ti kryejë këto funksione menaxheriale në mënyre adekuate. Kjo kërkesë ndaj Ministrit është e vlefshme edhe sa i përket implementimit të sistemit të KBFP-së.

Konkluzionet

Informatat në PVF për shumicën e Organizatave Buxhetore në të gjitha aspektet materiale janë të vërteta dhe të drejta. Në të njëjtë kohë, mbetet shumë për t'u bërë për të siguruar cilësi më të mirë të informatave. Nga auditimi ynë, ne konkludojmë se:

- Organizatat Buxhetore mjaft shpesh mbajnë evidenca jo të plota kontabël dhe PVF-të përgatiten duke përdorur Evidencat e Thesarit; dhe
- Mos prezantimi i pasurive me vlerën financiare dhe mos shpalosja e tyre në Pasqyrat Financiare.

Në të njëjtën kohë, ekzekutimi i buxhetit, menaxhimi financiar dhe kontrollet e brendshme janë problem më i madh. Edhe pse në disa raste nuk janë materiale, mangësitë në këtë aspekt shkaktojnë probleme edhe për kualitetin e raportimit të jashtëm si shtesë ndaj indikacioneve për sfida kur kemi të bëjmë me pajtueshmërinë si dhe me efikasitetin dhe efektivitetin në ekzekutimin e buxhetit.

Ne vlerësojmë përparimin e bërë gjatë vitit të kaluar kur bëhet fjalë për mbikëqyrjen e financave publike nga ana e Kuvendit. Një hap tjetër i paraparë në Planin e Veprimit për Menaxhimin Financiar që tashmë është e rregulluar përmes LMFPP-së është obligimi që bie mbi shpenzuesit buxhetor dhe Qeverinë, të fillohet me raportim të rezultateve të arritura. Deri më tani nuk kemi parë shenja të raporteve të tilla që në këtë mënyrë do të trasonin rrugën për një proces të buxhetit me fokus më të madh tek rezultatet e arritura.

Rekomandimet

Rekomandoj Kuvendin të:

- Mbajë seanca dëgjimore me personat përgjegjës në organizatat që raportojnë direkt Kuvendit;
- Mbajë seanca dëgjimore me personat përgjegjës në organizatat që kanë Opinion të Kundërt;
- Mbajë seanca dëgjimore me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave dhe atë të Pushtetit Lokal mbi masat që duhet ndërmerren për të siguruar raportim të jashtëm më të mirë nga Komunat; dhe
- Theksoj nevojën për pajtueshmëri me kërkesat mbi raportimin e rezultateve dhe të kërkoj përgjigje nga Ministri i Financave mbi atë se si ai ka ndër mend të përkrah masa të tilla.

3 Raporti Vjetor Financiar dhe Llogaridhënia e Qeverisë

3.1 Hyrje

Më 31 mars të vitit 2010, Qeveria ka dorëzuar Kuvendit dhe Auditorit të Përgjithshëm (AP), për shqyrtim Pasqyrat e saja Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2009.

Pasqyrat Financiare të BKK-së për VF 2009 duhet të hartohen mbi baza të kornizës së përgjithshme të krijuara nga LMFPP dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të Bazuar në Para të Gatshme (SNKSP).

Hartimi i pasqyrave financiare të BKK-së bazohet në të dhënat përfundimtare të Librit Kryesor të proceduara nga ana e Sistemit Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK).

Në hyrje të Pasqyrave Financiare është thënë se "ky raport është në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat e raportimit në bazë të Ligjit nr. 03/L-048, LMFPP dhe është në pajtim me SNKSP të bazuara në para të gatshme". "Ne konsiderojmë dhe besojmë fuqimisht se këto Pasqyra Financiare të Konsoliduara japin *pamje të drejtë dhe të vërtetë* të financave dhe transaksioneve financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për Qeverinë e Kosovës për vitin fiskal 2009"[3]

Së bashku, ekzistojnë tri (3) Pasqyra që përbëjnë Pasqyrat e përgjithshme të konsoliduara:

1. Pasqyrat e Konsoliduara të pranimit dhe pagesave në para të gatshme (4.3.2)
2. Pasqyrat e Konsoliduara të Krahasimit të Shumave Buxhetore dhe Aktuale (4.3.3)
3. Pasqyrat e Konsoliduara të pasurive në para të gatshme dhe bilancit të fondit (4.3.4)

AP-së i kërkohet me Ligj të shpreh një Opinion të Auditimit, në pajtim me standardet ndërkombëtarisht të njohura - ISSAI 400, për Pasqyrat financiare si tërësi. Ky kapitull adreson Opinionin e AP-së dhe konkluzionet kryesore që mbështesin opinionin e tij.

3.2 Qasja e Auditimit

Qasja për dhënien e Opinionit të Auditimit nga ana e AP-së, është si në vijim:

*Së pari b*ëhet një rishikim analitik duke u bazuar në burime të ndryshme të informatave për vlerësimin e kualitetit të PVF-ve, kryesisht dokumente të ndryshme të ndarjeve buxhetore dhe

3 Deklarata e Ministrit të Ekonomisë dhe Financave dhe Drejtorit të Thesarit, 26 Mars 2009, faqe 4.

shifrat e realizuara; bilancet në librat kontabël të organizatave buxhetore, sistemi i listës së pagave dhe sistemin e Librit të Përgjithshëm (Free Balance) në Thesar, si dhe vlerësimin e strukturës dhe klasifikimit të kërkuar nga SNKSP dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme.

Së dyti është dhënë një konkluzion i përgjithshëm dhe i konsoliduar i rezultatit të Auditimit të Rregullsisë për VF 2009, si dhe për rezultatet e Auditimit të Performancës.

Së treti AP krijon Opinionin e tij, në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht -ISSAI 400, për PVF-të bazuar në rezultatet e dy hapave të para.

Së katërti, AP-ja i jep Kuvendit rekomandimet në saje të rezultateve të tre hapave paraprake.

3.3 Rishikimi Analitik

3.3.1 Pasqyrat Financiare - Struktura dhe përmbajtja e përgjithshme

Buxheti për vitin 2009 është përgatitur dhe aprovuar në përputhje me Ligjin nr. 03/L-105, derisa rishikimi është bërë në pajtim me Ligjin nr. 03/L-167 për Ndarjet buxhetore për vitin 2009. Përmes këtij ligji janë përfshirë mekanizma të cilat mundësojnë ndryshimet në gjatë vitit.

Tabela 1 Ndarjet e Përgjithshme Buxhetore të VF 2009 (në '000€)

	Buxheti sipas Ligjit Nr: 03/L-105	Buxheti sipas Ligjit Nr. 03/L-167	Buxheti sipas SIMFK
Buxheti i Qeverisë Qendrore	976,799	1,111,276	1,110,677
Granti i Përgjithshëm i Qeverisë për Komunat për vitin 2009	206,000	204,100	215,115
Të hyrat vetjake të Komunave për vitin 2009	37,000	49,900	48,757
Të hyrat vetjake të Komunave të bartura nga viti 2008	-	-	24,943
Të hyrat vetjake të nivelit qendror për vitin 2009	-	-	18,326
Të hyrat vetjake të nivelit qendror të bartura nga viti 2008	-	-	6,112
Ndarjet e përgjithshme të fondeve për vitin 2009	1,219,799	1,365,276	1,423,929

Analizat e dallimeve ndërmjet PF-ve të BKK-së dhe organizatave individuale buxhetore

Nga analizat e bëra ndërmjet PF-ve të BKK-së dhe PF-ve të prezantuara në raportin vjetor financiar të organizave individuale në përgjithësi, kemi gjetur dallimet që janë të prezantuara në tabelën e mëposhtme:

Tabela 2 Dallimet ndërmjet PF-ve të BKK-së dhe Pasqyrat Financiare individuale në €

Përshkrimi	Pasqyrat Financiare BKK-së	Pasqyrat Financiare Individuale	Dallimet
Kuvendi i Kosovës			
Pasuritë Jo-financiare	7,222,570	7,212,508	10,062
Zyra e Kryeministrit			
Pasuritë Jo-financiare	3,489,811	5,007,985	(1,518,174)
Ministria e Ekonomisë dhe Financave			
Pasurisë Jo-financiare	1,152,918	2,842,428	(1,689,509)
Avanset e paarsyetuara	613	0	613
Ministria e Administratës Publike			
Pasurisë Jo-financiare	5,802,266	4,167,000	1,635,266
Faturat e papaguara	265,919	302,912	(36,993)
Ministria e Shëndetësisë			
Faturat e papaguara	112	1,734,722	(1,734,610)
Pasurisë jo-financiare	272,297,005	261,466,190	10,830,815
Avanset e paarsyetuara	86,001	149,117	(63,116)
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve			
Avanset e paarsyetuara	161	1,603,686	(1,603,525)
Universiteti i Prishtinës			
Pasurisë jo-financiare	1,443,967	1,437,819	6,148
Akademia e Shkencave dhe Arteve			
Pasurisë jo-financiare	83,195	76,145	7,050
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë			
Pasurisë jo-financiare	111,490,062	98,905,310	12,584,752
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale			
Faturat e papaguara	0	514,552	(514,552)
Pasurisë Jo-financiare	4,521,845	4,267,876	253,969
Avanset e paarsyetuara	19,069	18,748	321
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural			
Avanset e paarsyetuara	101,750	0	101,750
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor			
Pasuritë Jo-financiare	3,125,299	2,974,494	150,805
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë			
Pasuritë Jo-financiare	239,482	54,267	185,215
Ministria e Energjisë dhe Minierave			
Avanset e paarsyetuara	0	3,100	(3,100)
Faturat e papaguara	15,016	19,932	(4,916)
Pasuritë jo-financiare	581,622	531,119	50,503
Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit			
Faturat e papaguara	55,394	22,743	32,651
Pasuritë jo-financiare	270,676,663	270,381,450	295,213
Këshilli Gjyqësor i Kosovës			
Pasuritë jo-financiare	13,653,650	11873962	1,779,688
Faturat e papaguara	254,707	253,564	1,143
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës			
Pasuritë jo-financiare	0	7,594,610	(7,594,610)
Ministria e Drejtësisë			
Faturat e papaguara	11,783	461,787	(450,004)

3.3.2 Pasqyrat e pranimit dhe pagesave në para të gatshme

a) Analiza e të hyrave në para të gatshme

Kjo pasqyrë përmbledh totalin e arkëtimeve në para të gatshme sipas burimit të të hyrave

Të hyrat janë prezantuar si të ardhura dhe ato shpalosin shumën aktuale. Analizat na shtyjnë të konkludojmë se të hyrat në përgjithësi janë prezantuar me saktësi në pasqyrat financiare vjetore të vitit 2009.

Gjatë vitit 2009, shuma e të hyrave të mbledhura nga Doganat ishte 634,146,280€. Këto të hyra përbëjnë 55% të të hyrave të BKK për vitin 2009.

Kryesisht si burim i të hyrave nga Doganat janë: Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), akciza në artikuj të ndryshëm, taksat doganore, dhe të tjerat.

Gjate vitit 2009, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK-ja) ka arritur të mbledhë të hyra në shumë prej 206,469,030€. Duke përfshirë rimbursimet nga taksat e paguara në shumë prej 24,810,092€, vlera neto e të hyrave për vitin 2009 ishte 181,658,938€. Kur kjo krahasohet me vitin 2008, shuma ishte më e ulët për 19,174,966€, ose 10%.

Si rezultat i rënies së shkallës tatimore në kategoritë e caktuara të të hyrave, numri më i vogël i aktiviteteve të kontrollit dhe numri i vogël i bizneseve aktive që deklarojnë të ardhurat e tyre ka përfunduar në një nivel më të ulët të të hyrave të mbledhura në krahasim me vitin 2008.

Shqetësues është fakti që ka ardhur deri te rritja e vazhdueshme e obligimeve ndaj ATK-së nga viti në vit, kështu që vlera totale e obligimeve ka arritur në 269,155,190€. Për më tepër, vjetërsia e borxheve që kalojnë 6 vite ia vështirëson ATK-së kushtet e mbledhjes së këtyre borxheve.

Në fund të vitit 2009, gjendja e obligimeve, që janë vjetruar më shumë se 6 vjet e që me kornizën ligjore nënkupton se ato duhet të konsiderohen të pa mbledhshme dhe të fshihen, ka arritur vlerën prej 90,688,967€.

Kemi vërejtur se regjistrimi i të hyrave është bërë në mënyrë të rregullt dhe korrekte më përjashtim të disa mangësive që kanë të bëjnë me:

- Harmonizimet me kohë ndërmjet organizatave buxhetore (OB) dhe Thesarit;
- Mos regjistrimi i transaksioneve në kodet ekonomike adekuate; dhe
- Mungesa e aktiviteteve për grumbullimin e të hyrave;

Rekomandim:

Ne i rekomandojmë MEF-it që të siguroj se:

Janë ndërmarrë masa që kanë të bëjnë me analizimin e dobësive të paraqitura dhe të krijojë procedura të qarta dhe të përshtatshme të kontrollit të brendshëm, lidhur me inkasimin regjistrimin dhe shpenzimin e të hyrave.

b) Analiza e Pagesave

Pagat dhe Mëditjet

Barazimi

Sistemi i pagave i administruar nga MAP-i nuk ka bërë barazime me Librin Kryesor të Thesarit. Dallimi është si në vijim:

Pagat sipas Thesarit	268,925,054
Pagat sipas listës së pagave	242,061,789
Dallimi	26,863,263

Kjo është e barabartë me 10% të shpenzimeve totale të pagave dhe është shumë më e lartë se në vitin 2008, ku dallimi ishte 0,34%.

Siç është shpjeguar më herët, dallimet mund të shpjegohen nga faktet se një numër i madh i Organizatave Buxhetore i paguajnë pagat nga të hyrat vetjake dhe se një pjesë e pagave paguhen drejtpërdrejt nga Thesari.

Lista e Pagave

Sistemi i pagave menaxhohet nga Ministria e Administratës Publike. Ky është një sistem i centralizuar që përdoret pothuajse nga të gjitha institucionet për kryerjen e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me listën e pagave.

Shumica e komunave nuk e kanë një sistem të brendshëm të pagave për të gjitha departamentet e tyre sikurse të dhënat themelore bankare. Barazimet me sistemin qendror janë të komplikuara dhe mundësitë për gabime dhe shkelje nuk duhet të nënvlerësohen. Situata ka ndikim në mundësinë për të prodhuar Pasqyra të vërteta dhe të drejta Financiare.

Rekomandim

- MEF-i duhet ta theksojë rëndësinë e barazimeve solide të pagesave të pagave ndaj atyre llogaridhënës; dhe
- MEF-i duhet të shqyrtojë mundësitë për të prezantuar më shumë zgjidhje transparente që mbulojnë pagat në total.

Mallrat, Shërbimet dhe Investimet Kapitale

Ne kemi identifikuar mënyra të ndryshme të raportimit gjatë krahasimit të pasqyrave financiare të BKK-së dhe sistemit kontabël të Thesarit (SIMFK). Dallimi në prezantim ndodh për faktin se Qeveria është përpjekur të jetë transparente në PVF-të e BKK-së duke prezantuar veçmas:

- Pagesat nga detyrimet ndërkombëtare; dhe
- Pagesat e bëra nga donatorët jashtë BKK-së.

Konkluzioni

Mënyra se si Qeveria i ka prezantuar pagesat e bëra nën kategorinë Mallra dhe Shërbime në njërën anë është më transparente, dhe në anën tjetër informacioni rreth pagesave totale të bëra mund të gjendet nën linjat e veçanta të raportimit.

Rekomandim

Ne e rekomandojmë MEF-in që të marrë parasysh në të ardhmen të shpalosë metodën e përdorur për këtë prezantim më shumë në thellësi.

3.3.3 Pasqyra e Konsoliduar Krahasuese e Buxhetit dhe Shumat Aktuale

Ne e kemi analizuar realizimin e buxhetit në krahasim me buxhetin fillestar, të rishikuar dhe final.

Shpenzimet e përgjithshme të BKK-së ishin 86.5% e buxhetit të aprovuar për vitin 2009. Derisa, buxheti për projektet kapitale e kishte nivelin më të ulët të implementimit me vetëm 80.3% të planifikimit.

Ne kemi ardhur në konkludim se kjo Pasqyrë, në të gjitha aspektet materiale, i jep pamje të vërtetë dhe të drejtë të rezultateve financiare në krahasim me buxhetin e aprovuar.

Mirëpo, ne kemi identifikuar disa mangësi jo materiale të cilat nuk ndikojnë negativisht në përmbajtjen e Pasqyrës dhe ne dëshirojmë që t'ia prezantojmë ato lexuesit.

- Prej 54 shpenzuesve Buxhetor, 24 prej tyre e kishin një nivel më të ulët të implementimit të buxhetit sesa mesatarja (nga 28% deri në 80%);
- Ekziston një trend për shpenzime më të larta në fund të vitit;
- Në disa raste individuale, Pagat dhe Mëditjet ishin financuar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve duke përdorur kontratat për shërbime specifike, dhe
- Mangësi sa i përket procedurave të përdorura ligjore dhe kritereve të aplikuara për rialokimet e fondeve të pashfrytëzuara ose të dedikuara për projekte të tjera.

Konkluzioni

Ende ka hapësirë për forcim të përgjithshëm të procesit të planifikimit si dhe të planifikimit të projekteve individuale. Për më tepër, trendi për rritjen e shpenzimeve në fund të vitit ndodh kryesisht për t'iu shmangur suficitit buxhetor dhe është një tregues i planifikimit joadekuat.

Rialokimet e shpeshta midis kategorive buxhetore e bëjnë që përbërja e shpenzimeve të ndryshojë nga buxheti fillestar. Në raste të tilla, buxheti nuk do të shërbejë si një pasqyrë e dobishme siç synon politika.

Rekomandime

> Ne e rekomandojmë MEF-në që të marrë iniciativën për ti analizuar faktorët të cilët kanë mundur të shpijnë në implementim të gabuar të buxhetit, në mënyrë që të kuptohen arsyet e devijimit nga shpenzimet e buxhetuara, dhe të ndërmarrë masat e duhura për ta bërë sa më efektiv procesin e buxhetit.

3.3.4 Pasqyrat e Konsoliduara të Pasurive në Para të Gatshme dhe Bilanci i Fondit

Kjo Pasqyrë Financiare është e bazuar në të dhënat që mbahën nga të Dhënat Kontabël të Thesarit(SIMFK). Ne e kemi kontrolluar saktësinë e të dhënave të prezantuara në këtë pasqyrë duke e krahasuar atë me të dhënat e njëjta që mbahen brenda SIMFK-ut dhe llogarive bankare në BQK.

Tabela 3 Krahasimi në mes PVF-ve dhe llogarive bankare (in 000€)

PASQYRAT FINANCIARE NË PARA TË GATSHME			
	Shënimet në PF të BKK-së	2009 PF të BKK-së SIMFK	2009 BKK, Burime tjera
Banka Qendrore e Kosovës	23	88,311	88,232
Depozitat e afatizuara në BQK	23.1	125,000	25,000
Depozitat në bankat e jashtme	-	-	100,000
Depozitat e afatizuara në banka komerciale	24	163,922	163,922
Paraja e gatshme në transit	25	5,793	5,793
Llogaritë e Ambasadave të Republikës së Kosovës	26	557	557
Paraja në dorë (arka)	27	270	270
Totali i Pasurive		383.853	383,774

Të dhënat e paraqitura tregojnë një diferencë totale prej 79.000€.

Normat e Depozitave të Afatizuara në BQK

Depozitat e afatizuara në BQK, të paraqitura në PF janë në shumë prej 125,000,000•. BQK-ja-si ndërmjetësuese- ka depozituar 100,000,000• në banka jashtë vendit (qoftë në formë të letrave me vlerë apo bonove të Thesarit).

Depozitat në Bankat Komerciale

Fondi i mjeteve nga dividendët, aksionar i vetëm i të cilit është MEF-i, janë të depozituara në bankat komerciale vendore. Vlera e këtyre mjeteve ndryshon varësisht nga afati i maturimit të tyre.

Konkluzioni

Sipas mendimit tonë, prezantimi i rezultatit të përdorimit të instrumenteve financiare nuk janë shpalosur mjaft qartë në PVF-të e BKK-së. Forma e prezantimit të këtyre mjeteve nuk jep informacion të mjaftueshëm as për llojin e investimeve dhe as për rezultatet e dala nga to.

Rekomandime

> Ne rekomandojmë MEF-in që në të ardhmen të shpalosë më në thellësi përdorimin e instrumenteve financiare dhe rezultatin nga to.

Dividendat

Sipas vendimit të Qeverisë, PTK-ja i ka deklaruar dividendët e saj në shumë prej 200.000.000€ dhe kishte vendosur që këto fonde të bëhen pjesë e BKK-së.

Në kohën e deklarimit të dividentës PTK kishte të investuar të gjithë shumën në depozita me afat në shtatë banka komerciale. Në secilën bankë shuma ishte investuar në formë të fondeve më të vogla me shkallë të ndryshme të interesit, varësisht nga koha e maturimit.

Ministri i financave e caktoi një komision për ta këshilluar atë mbi mënyrën se si ti adresojë dividendët. BQK, MEF-i, dhe partnerët ndërkombëtarë ishin gjithashtu të përfaqësuar. Bazuar mbi këshillën e komisionit u morën hapat në pajtim me planin specifik të veprimit.

Vendimet e marra ishin ndikuar nga privatizimi i parashikuar i PTK-së si dhe nga ndikimi potencial mbi sistemin bankar nëse tërheqja e fondeve nga bankat komerciale nuk do të ishte menaxhuar me kujdes. Fondet e PTK-së e përbëjnë pjesën më të madhe të depozitave të përgjithshme. Dhe me ndonjë ndikim të mundshëm nga kriza globale financiare si dhe me qëllim që të ruhet stabiliteti i sektorit bankar në Kosovë, ishte vendosur që fondet nga dividendët duhej të transferoheshin në BQK në mënyrë të rregullt, transparente dhe të drejtë me synim të qartë për të ofruar stabilitet në sistemin bankar.

Mënyra se si është shpalosur trajtimi i dividendëve në Pasqyrat Financiare lë hapësirë për përmirësim. Nuk është e lehtë për një lexues të jashtëm që ta kuptojë qëllimin e transaksionit, proceset dhe rezultatet financiare.

Konkluzion

Sipas pikëpamjes tonë përshkrimi i transaksionit të kësaj dividendi në Pasqyrat Financiare ka mundur të jetë më i mirë dhe qëllimi i deklarimit të dividentës të qartësohet më mirë. Për më tepër, mandati i Komitetit të themeluar për investimet e dividendëve ka mundur të jetë caktuar më herët në Termat e Referencës. Analizat e bëra, vlerësimi i rrezikut dhe skenarët duhet të mblidhen si bazë e dokumentuar për vendimet e marra.

Rekomandim

Ne rekomandojmë MEF-in që të sigurojë se:

- Qëllimi dhe rezultatet e investimeve të shpalosën qartë në pasqyrat financiare;
- Vendimet që merren dhe baza për to, të jenë të dokumentohen dhe të mbahen si duhet; dhe
- Prezantimi i procesit, duke përfshirë veprimet e marra dhe pasqyrat financiare.

Detyrimet e papaguara

Korniza ligjore e parasheh përgatitjen dhe dorëzimin e Pasqyrave Financiare në Thesar që nga 31 janari i vitit 2010. Kjo kërkesë nuk është respektuar nga të gjitha organizatat raportuese të buxhetit. Kemi pasur raste ku PF janë dorëzuar me vonesë në Thesar.
Sipas zyrtarëve të MEF-it, kjo është arsyeja pse Thesari gjatë përgatitjes së Pasqyrës Financiare nuk ishte në gjendje ti paraqes plotësisht detyrimet e papaguara siç parashihet në Shtojcën e 7 të RVF.

Ne i kemi rishikuar disa PF të organizatave buxhetore dhe kemi vërejtur se shpalosja obligative e detyrimeve të papaguara në PF-të e BKK-së nuk ishte bërë.

Konkluzion

Dështimi për ti dorëzuar raportet financiare me kohë, mos shpalosja e shënimeve të Pasqyrave Financiare (shtojcat). Për më tepër, neglizhenca nga ana e zyrtarëve të Thesarit ka pasur ndikim në saktësinë dhe tërësinë e detyrimeve në fund të vitit.

Rekomandim

Ne e rekomandojmë MEF-in që të sigurojë se:

- Do të ndërmerren masat e nevojshme për përmirësimin e komunikimit midis MEF-it (Thesarit) dhe njësive raportuese, me qëllim që të sigurohet se raportimi vjetor bëhet me kohë; dhe
- Detyrimet në fund të vitit të prezantohen si duhet.

3.4 Opinioni i Auditimit në Pasqyrat e Konsoliduara Financiare

Opinioni i konsoliduar dhe gjithëpërfshirës i auditimit nga AP si përmbledhje konkludon se:

"Pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një prezantim *të vërtetë dhe të drejtë* të financave si dhe gjendjen financiare të Fondit të Konsoliduar të Kosovës për Qeverinë e Kosovës për vitin fiskal 2009 ".

Dhe si rrjedhojë, ky është një ***Opinioni i Pakualifikuar i Auditimit*** në përputhje me ISSAI 400 (shih. shtojcën 1)

Për më tepër, Pasqyrat Financiare janë përpiluar në pajtim me standardet e zbatueshme (SNKSP) si dhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Njëkohësisht, auditimi ka zbuluar një numër mangësish që kanë të bëjnë me implementimin e buxhetit. Këto mangësi kanë të bëjnë me të metat në Menaxhimin e Financave Publike dhe me sistemet e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike dhe mënyra se si janë implementuar, në të dyja nivelet në atë qendror dhe në atë të shpenzuesit buxhetor.

Në kapitujt tjerë të këtij raporti, këto mangësi janë përshkruar dhe analizuar si dhe janë dhënë rekomandimet se si duhet të adresohen ato.

4 Performanca Financiare e Organizatave Buxhetore

4.1 Hyrje

Ne kemi kryer:

- Auditim të plotë të Rregullsisë në 65 Pasqyra Vjetore Financiare (PVF) në kuadër të BKK-së, me raporte të jashtme të auditimit, si dhe një Opinion të Auditimit në përputhje me standardet e pranuara ndërkombëtarisht të auditimit (ISSAI 400);
- Auditime të plota të rregullsisë të PVF-ve për ndërmarrjet publike (kompania regjionale e ujërave "Prishtina" dhe kompania regjionale e mbeturinave "Pastrimi";
- Auditim të Menaxhimit në Termokos dhe në Radio Televizionin e Kosovës (RTK); dhe
- Dy Auditime të Performancës me raporte publike të auditimit, për herë të parë.

Kjo do të thotë se të gjitha Organizatat më të mëdha Buxhetore kanë pasur Auditim të plotë të Rregullsisë duke përbërë përafërsisht 80% të shpenzimeve dhe përafërsisht 95% të hyrave të Buxheteve të Sektorit Publik të Kosovës.

Të gjeturat tona të auditimit për VF 2009
Sipas auditimeve tona të *PVF-ve të shpenzuesve individual buxhetor*, ne kemi dhënë opinionet e auditimit në vijim:

- Pesëmbëdhjetë të Pakualifikuara;
- Gjashtëmbëdhjetë të Pakualifikuara me Theksim të Çështjes;
- Katër të Kualifikuara;
- Njëzetenëntë Mohime; dhe
- Dy Opinione të Kundërta.

Në shtojcën 2 mund të gjendet një tabelë e cila i përfshin opinionet e dhëna dhe mangësitë më të mëdha Menaxheriale e organeve të audituara individuale. Për informata më specifike në lidhje me raportet mund të gjinden në faqen tonë të internetit: www.ks-gov.net/oag

Konkluzionet

Informatat në PVF-ë për shumicën e Organizatave Buxhetore, në të gjitha aspektet materiale, janë të vërteta dhe të drejta. Njëkohësisht, shumë duhet të bëhet për tu siguruar informacione me cilësore. Nga shënimet e tabelës, ne konkludojmë se:

- Organizatat Buxhetore shpesh herë i mbajnë të paplotë regjistrat e tyre kontabël si dhe PVF-të janë përgatitur duke përdorur të dhënat e Thesarit; dhe
- Mos prezantimi i pasurive në vlerën e tyre financiare dhe mos shpalosja e tyre në Pasqyrat Financiare.

Njëkohësisht, realizimi i buxhetit, menaxhimi financiar si dhe kontrollet e brendshme janë problem më i madh. Edhe pse jo material në shumicën e rasteve, mangësitë e tilla gjenerojnë probleme edhe në cilësinë e raportimit të jashtëm, përveç faktit se janë tregues të sfidave në lidhje me pajtueshmërinë si dhe me efikasitetin dhe efektivitetin në realizimin e buxhetit.

Një hap i mëtejmë që është paraparë në LMFPP-në, është fillimi i raportimit i rezultateve të arritura, të lidhura me treguesit e performancës që rrjedhin nga strategjia përkatëse për Shpenzuesin e Buxhetit. Deri më tani ne nuk kemi parë shenja të raporteve të këtij lloji.

Rekomandim

- Kuvendi do të mbaj dëgjimore me personat përgjegjës të organizatave që kanë opinion të kualifikuar ose me opinion të kundërt;
- Menaxheri i organizatës individuale buxhetore do ta dorëzojë Planin e tij të Veprimit duke i adresuar mangësitë në MEF; dhe
- MEF-i duhet që së paku para fundit të marsit të vitit 2010, ta informojë Kuvendin në lidhje me miratimin dhe implementimin e këtyre planeve.

4.2 Veprimet mbi Gjetjet dhe Rekomandimet e mëparshme të Auditimit

Raporti ynë i fundit vjetor i auditimit i Pasqyrave të Konsoliduara Financiare të Qeverisë për vitin 2008 ka rezultuar me 10 (dhjetë) palë rekomandime. Të gjitha rekomandimet iu janë dhënë Kuvendit dhe të adresohen ose nga vetë Kuvendi ose nga Qeveria dhe agjencitë e saj.

Sa i përket adresimit të këtyre rekomandimeve, në praktikë një progres i madh është bërë edhe pse ende mbetet shumë punë për tu bërë, për tu siguruar se mangësitë e identifikuara janë adresuar tërësisht.

Në këtë kontekst, Kuvendi ka bërë përpjekje të shumta dhe ka treguar rezultate praktike për adresimin e çështjeve në vijim, për çka edhe kemi dhënë disa rekomandime.

Kuvendi ka bërë ndryshime pozitive për mbylljen e zinxhirit llogaridhënies, duke mbajtur dëgjimore publike me personat llogaridhënës të organizatave për të cilin raportet e auditimit i kanë theksuar mangësitë e rëndësishme;

Përveç kësaj janë disa rezultate të vërejtura sa i përket themelimit të rutinës standarde për trajtimin e raporteve të auditimit të performancës në kuadër të Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Sidoqoftë, palët e rekomandimeve në vijim nuk janë adresuar tërësisht:

- Në lidhje me sistemin e pagave. Ende ekzistojnë dallime në mes të dhënave të mbajtura në sistemin e pagave dhe me të dhënat kontabël të Thesarit (SIMFK). Si dhe në praktikë ka disa raste ku pagat ende paguhen e që nuk janë në përputhje dhe transparente me raportimin;
- Në lidhje me të hyrat e Administratës Tatimore të Kosovës, ekzistojnë disa përmirësime por prapëseprapë sistemi është i shoqëruar me disa të meta, posaçërisht sa i përket trajtimit të taksave mbi të ardhurat personale e që paguhen nëpërmes administratës publike;
- Në lidhje me menaxhimin e pasurive fikse. Ende ekzistojnë prona që nuk janë regjistruar në regjistrat e OB-ve. Dallimi ekziston në mes PVF-ve të Qeverisë dhe Pasqyrave Financiare të organizatave buxhetore; dhe
- Në lidhje me prokurimin publik, përveç progresit të arritur, ende ekzistojnë disa çështje të cilat nuk janë adresuar posaçërisht nga KRPP-ja. Është e vështirë të gjinden fakte solide se monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve të prokurimit është forcuar dhe sistemi me listën e aprovuar të palëve shitëse ishte marrë parasysh për tu themeluar në kuadër të KRPP-së.

Rekomandimet në vijim janë në procesin e implementimit:

- Në lidhje me të hyrat e Doganës, ekzistojnë përmirësime të qarta sa i përket zvogëlimit të numrit të gabimeve në krahasim me vitin e kaluar;
- Në lidhje me funksionin e auditimit të brendshëm, vërehet progres i dukshëm në zhvillimin e mëtutjeshëm të sistemit të përgjithshëm të auditimit të brendshëm. Vazhdon që të ketë progres dhe ndryshimi i vërtetë mund të vërehet në një perspektive më të gjatë; and
- Në lidhje me forcimin e mëtutjeshëm të NjQH/MFK, MEF-i ka arritur progres në vënien në funksion të njësisë, ka më tepërt staf, edhe pse ka nevojë për zhvillim të mëtutjeshëm kur është fjala për kompetencat e organizatës.

4.3 Pajtueshmëria në implementimin e buxhetit për vitin 2009

Politikat qeverisëse dhe projeksionet e buxhetit të zhvilluara nga Qeveria në pajtim me LMFPP-në e përcaktojnë dokumentin bazë për rishikim dhe miratimin e ndarjeve buxhetore të fondeve publike për institucionet publike.

Miratimi i Ligjit për Buxhetin e hap një rrugë ligjore për shpenzimet e buxhetuara, sipas Ligjit dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Ligji i lejon lëvizjet e kufizuara të fondeve në disa linja të caktuara dhe brenda programeve të buxhetit, sipas kritereve dhe disa procedurave dhe ndryshim–plotësimeve, nën procesin e rishikimit gjashtëmujor të buxhetit.

Paraja publike duhet të përdoret vetëm për qëllimet e miratuara, dhe nga fondet e ndara dhe të alokuara, sipas procedurave të LMFPP-së dhe ndonjë legjislacioni tjetër sekondar për implementimin e këtij Ligji.

Auditimet e rregullsisë që janë kryer për vitin financiar 2009, kanë shfaqur mospërputhjet me Ligjin për Buxhetin që kanë ndodhur gjatë menaxhimit financiar të Organizatave Buxhetore. Mospërputhjet më të vërejtura janë në:

- Planifikimin dhe përdorimin efikas të buxhetit, pasi që kjo ka ndikuar shumë në nivelin e implementimit, sipas ndarjeve finale buxhetore (nga 54 institucione në nivelin qendror, 24 prej tyre kanë e realizuar buxhetin me një nivel shumë të ulët - nga 28% deri në 80%);
- Procedurat e pagesave ku një numër i konsiderueshëm i organizatave buxhetore i kanë kryer pagesat e pagave nga kategoria e Mallrave përmes marrëveshjeve për shërbime speciale;
- Implementimin e rregullave për dhënien dhe mbylljen e avanseve;
- Dështimin për ti arsyetuar dhe për ti mbyllur avanset për udhëtime zyrtare;
- Ekzekutimin e kritereve dhe procedurave ligjore për transferimin e mjeteve nga vija të ndryshme të pashfrytëzuara buxhetore apo tepricat nga projekte të caktuara në pajtim me nenin e 13 të këtij ligji;
- Planifikimin dhe përgatitjen e vonshme për ekzekutimin e projekteve kapitale, përkatësisht ftesën për tenderë për projektin kapital në periudhën finale të vitit financiar dhe pagesa e mjeteve pavarësisht faktit se punët nuk kishin përfunduar(filluar) për shkak të përfundimit të vitit buxhetor;
- Ndarjen e subvencioneve për Ndërmarrjet në Pronësi Publike dhe mbikëqyrje e pamjaftueshme mbi shpenzimet e shkaktuara siç janë paraparë dhe bartja e pjesës së pashpenzuar në formë të avanseve në vitin që vjen; dhe
- Vendosjen e kritereve dhe mbikëqyrjen e subvencioneve të ndara për aktivitetet e entiteteve private (në fushën e bujqësisë).

Ekzekutimi jo i plotë dhe mos-pajtueshmëria me dispozitat e Ligjit për Buxhetin në menaxhimin financiar nga organizatat buxhetore është një tregues i përdorimit irracional të parave publike dhe jo efikasitetit në përmbushjen e shërbimeve publike.

Rekomandime

Unë rekomandoj Kuvendin që:

- Në mënyrë aktive dhe për së afërmi ta ndjek zbatimin e këtij ligji, në mënyrë që të përdoret siç duhet, në mënyrë racionale, siç është paraparë, dhe në koherencë me ndarjet buxhetore;
- Të kërkojë përgjegjësi më të madhe nga institucionet mbikëqyrëse të organizatave buxhetore në implementimin e legjislacionit për menaxhimin e parasë publike;
- MEF-i të harton udhëzime të qarta për përfshirjen e planeve të investimeve kapitale në buxhetet e institucioneve vetëm nëse këto ofrojnë siguri të mjaftueshme dhe të dokumentuar, në mënyrë që të jetë mundësia për ekzekutimin e programeve në kohën e duhur, dhe
- Të kërkojë nga Qeveria që të ndërmarrë masa, në mënyrë që sistemet e kontrollit të brendshëm të implementohen në mënyrë më efektive.

5 Menaxhimi Financiar

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (MFK) është një proces gjithëpërfshirës i cili është i integruar në aktivitetet e Organizatës, dhe kryhet nga menaxhmenti dhe stafi. MFK-ja shkon përtej llogaridhënies dhe funksioneve financiare, siç janë shpenzimi brenda limiteve buxhetore dhe përputhshmëri me procedurat financiare. Qëllimi i MFK-së është që të sigurojë se burimet shfrytëzohen për arritjen e objektivave të organizatës.

Në punën tonë të auditimit ne shpeshherë vërejmë se vëmendje e tepruar ju jepet çështjeve që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë e kontrolleve financiare, kurse shpeshherë aspektet e MFK-së neglizhohen.

5.1 Politika e KBFP-së

Në vitin 2005 Qeveria ka miratuar Politikën e parë të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP). Kjo ishte ndryshuar në vitin 2007.

Sistemi i KBFP-së përbëhet nga dy nën-sisteme: *Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (MFK)* dhe *Auditimi i Brendshëm.*

Objektivat e sistemeve të MFK-së vlejnë për të gjitha programet dhe aktivitetet administrative. Sistemet e MFK-së janë të dizajnuara që ta sigurojnë një gjë të tillë:

a. Obligimet dhe shpenzimet janë ne pajtim me ligjin e aplikueshëm.
b. Pasuritë janë ruajtur ndaj shpërdorimit, humbjes, përdorimit të paautorizuar dhe keqpërdorimit.
c. Te hyrat dhe shpenzimet, detyrimet dhe mbledhja e shumave të papaguara për aktivitetet e organizatave buxhetore janë regjistruar dhe llogaritur si duhet, kështu që llogaritë dhe raportet e besueshme financiare dhe statistikore mund të përgatiten dhe përgjegjshmëria për pasuritë mund të ruhet.
d. Programet janë kryer me efikasitet dhe efektivitet për ti përmbushur objektivat në pajtim me ligjin e zbatueshëm dhe politikën menaxhuese.
e. Të gjitha rreziqet menaxhuese janë zbuluar dhe adresuar me një kontroll përkatës dhe proporcional.

Menaxheri duhet ta përmbush përgjegjësinë e vet të MFK-së me përkrahjen e një auditori të brendshëm të pavarur, që i jep një vlerësim objektiv për implementimin dhe cilësinë e sistemeve të MFK-së.

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur objektiv dhe sigurues, i dizajnuar për të shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e organizatës. Kjo i ndihmon një organizate që ti përmbushë objektivat e saj duke i sjellë vlerësimit një qasje sistematike , të disiplinuar dhe përmirësimin e efikasitetit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe proceseve qeverisëse.

Të dyja nënsistemet janë të ndara në aplikacione qendrore dhe lokale me përgjegjësi të ndryshme të ndërlidhura me rolet dhe mbulimi përkatës. Njësia përkatëse Qendrore Harmonizuese në kuadër të nënsistemeve (MFK dhe AB) është i rëndësishëm në shumë aspekte duke dhënë parakushte dhe mbështetje të ndryshme për implementimin e duhur të sistemeve.

Konkluzionet

Pavarësisht nga progresi i bërë, ekziston një numër mangësish në ekzekutimin e buxhetit të shpenzuesit buxhetor. Ato shpesh janë të lidhura me të metat në implementimin e sistemim të KBFP në tërësi dhe me një përdorim të kufizuar të "mjeteve në kutinë e mjeteve". NJQH/MFK duhet të japë arsyet për të gjeturat tona duke qartësuar mospërputhjet në kornizën ligjore, aktivitetet në ngritjen e vetëdijesimit, trajnime, prodhimin e formateve, shpërndarjen e shembujve të mirë, etj.

Auditimi i kryer në vitin e kaluar së bashku me përvojat në ekzekutiv na bën të konkludojmë se nevojiten masa për:

- Përmirësimin politikës së KBFP dhe kornizës ligjore; dhe
- Futjen e metodave dhe qasjeve të reja.

5.2 Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit

Ende ka hapësira për forcimin e planifikimit të përgjithshëm si dhe për planifikimin e projekteve individuale. Ekzekutimi i buxhetit ende është i nivelit jo të kënaqshëm sidomos buxheti për projekte kapitale. Kjo ishte ndikuar kryesisht ose nga vonesat në implementimin e projekteve të ndryshme ose në dështimin e tyre.

Implementimi i dobët i buxhetit e zvogëlon mundësinë e Qeverisë që të ofrojë shërbime publike për vitin sipas deklarimeve në politika.

Përveç kësaj, implementimi i dobët i buxhetit gjatë vitit ka për tendencë të çojë drejt shpenzimeve më të mëdha në fund të vitit kur entitetet luftojnë që ti shmangen suficitit. Ky është një tregues i planifikimit dhe kontrollit të dobët mbi buxhetet kapitale.

Ridestinimi i mjeteve ndërmjet kategorive buxhetore është i shpeshtë duke bërë që kompozimi i shpenzimeve të dallojë nga ai i parashikuar në buxhetin origjinal. Në raste të tilla, buxheti nuk shërben si një deklaratë e dobishme e synimeve politike.

Mungesa e përgjithshme shkathtësive të duhura të MFK-së brenda Organizatave Buxhetore ka rezultuar në ekzekutimin joadekuat të buxhetit.

5.3 Raportimi

Për të siguruar transparencë, informatat e Qeverisë në lidhje me NP-të duhet të jenë të qasshme nga publiku i gjerë - ose së paku për grupet relevante me interes.

Në pajtim me Ligjin e MFPP-së, çdo organizatë buxhetore do ti përgatit dy lloje të raportit; Raportet Vjetore Financiare deri më 31 janar dhe Raportet Vjetore Operacionale (RVO) duke u bazuar në pasqyrat e audituara financiare e secilit vit financiar.

Në realitet, institucionet zakonisht i përpilojnë PVF-të, por dështojnë në përpilimin e RVO-ve. Por megjithatë disa i përpilojnë, por pastaj format e raporteve përpilohen për shkak të pritjeve të donatorëve të huaj, të tregut etj. Për tu përdorur si vegël, këto raporte në dialogun e buxhetit i cili është i paraparë në kuadër të procesit të buxhetit, nuk janë të mjaftueshme.

5.4 Korniza Ligjore e MFK-së

Ekziston një kornizë e mjaftueshme legjislative për menaxhimin financiar dhe të kontrolleve. Si dhe një kornizë institucionale për implementimin e legjislacionit. Progresi është arritur në përkufizimin e kontrolleve të brendshme si dhe në zhvillimin e legjislacionit të lidhur sekondar dhe terciar. Sidoqoftë, sfida tani është se si të arrihet implementimi efektiv dhe i qëndrueshëm i kornizës ekzistuese ligjore.

Në këtë kuptim dhe me qëllim të implementimit efektiv të rregullave qendrore , menaxherët e OB pritet ti përpunojnë më tutje ato rregulla duke ia përshtatur rrethanave të veçanta që ekzistojnë në organizatat e tyre. Në praktikë kjo ndodh rrallë, OB nuk kanë të zhvilluar dokumente të brendshme por rregullat e thesarit i implementojnë drejtpërsëdrejti gjë që shpesh krijon sfida gjatë implementimit të kontrolleve të brendshme financiare.

Një numër i mangësive të identifikuara në ekzekutimin e buxhetit të organizatave buxhetore tregon se sistemi i krijuar i kontrolleve të brendshme nuk ka funksionuar si duhet për të parandaluar, zbuluar dhe korrigjuar gabimet dhe parregullsitë e mundshme.

5.5 Reformat

Qeveria ka bërë përpjekje për krijimin e një mjedisi efektiv të kontrollit. Ekziston procesi për implementimin e Planit të Veprimit për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike mirëpo është ende herët për ti vlerësuar rezultatet e para. E tërë fusha e legjislacionit për Menaxhimin e Financave Publike është në proces të rishikimit duke përfshirë politika të reja të kontrolleve të brendshme financiare si dhe rregullave dhe udhëzimeve financiare të Thesarit. Procesi i pagesave po ashtu është në proces të decentralizimit.

5.6 Çertifikimi

Ne kemi kryer auditimin e funksionimit të procesit të Certifikimit. Përkundër rolit parandalues të funksionit të certifikimit, ne ende gjejmë raste të certifikimit pagesave të parregullta. Gjatë punës sonë të auditimit ne kemi gjetur rastet ku:

- Kishte raste të mospajtueshmërisë me kornizën legjislative në fuqi;
- Kishte fakte të pamjaftueshme për të dëshmuar se kushtet e kontratës janë përmbushur para ekzekutimit të pagesës;
- Fondet ishin zotuar pasi që ishte nënshkruar kontrata; dhe
- Shpenzimet nuk ishin regjistruar në kodet përkatëse ekonomike etj.

Këto të gjetura të auditimit tregojnë se procesi i certifikimit të pagesave nuk ishte mjaft efektiv. Zyrtarët Certifikues nuk janë gjithmonë të aftë që t'i parandalojnë pagesat e parregullta, që do të thotë se procesi i certifikimit është joefektiv për qëllimin që është synuar. Procesi i certifikimit nuk është një element efektiv në sistemin qeveritar të menaxhimit financiar duke ia lënë shtetit barrën e rrezikut financiar.

Roli i ZÇ-së duhet të sqarohet. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e vendit të ZÇ-së në zinxhirin e përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së ZÇ-së për certifikimin e pagesave. Një rishikim i tillë duhet të bazohet në parimet dhe qasjet e mishëruara në politikën e re të KBFP-së dhe në Udhëzimet e Thesarit dhe rregullat financiare.

Të gjeturat e përmbledhura

Auditimi jonë ka gjetur mangësi në të gjitha aspektet e procedimit të pagesave ku procesi i mirë certifikues do të duhej ti prezantonte dhe/ose vërejtur:

- Fakte të pamjaftueshme për të dëshmuar se kushtet e kontratës janë përmbushur para ekzekutimit të pagesës;
- Raportet nuk janë bërë me shkrim ;
- Kërkesat e LPP-së nuk janë respektuar;
- Faturat e paguara pas datës së pagesave nuk janë raportuar fare nga ZÇ-ja;
- Shpenzimet janë klasifikuar në kode të gabueshme; dhe
- Fondet ishin zotuar pasi që ishte nënshkruar kontrata.

Këto mangësi kanë ndikuar në 45% të mostrave të rishikuara në transaksione.

Shkaqet e mundshme

Auditimi jonë ka vërejtur mangësi të shumta të cilat e vështirësojnë parandalimin e pagesave të parregullta:

- Zyrtarët Çertifikues nuk janë të qartë në rolin e tyre apo pritjet e performancës;
- Përshkrim i paqartë i punës;
- Zyrtarëve Çertifikues nuk kanë aftësi të mjaftueshme për ta kryer punën e tyre;
- Zyrtarët Çertifikues nuk janë të motivuar; dhe
- Zyrtarët Çertifikues nuk mbikëqyrën mjaftueshëm.

Organizim i pamjaftueshëm i procesit duke ja bërë të pamundur Zyrtarit Çertifikues që gjithmonë ti parandaloj pagesat e parregullta, ku kjo e bën procesin e çertifikimit joefektiv për qëllimin e paraparë.

Procesi nuk i ndalon pagesat e parregullta dhe për këtë arsye ky është një element i pasuksesshëm në sistemin Qeveritar të menaxhimit financiar duke ja lënë shtetit barrë rrezikun financiar.

Rekomandimet për Ministrin e Ekonomisë dhe Financave:

1. Roli i ZÇ-së duhet të sqarohet. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e vendit të ZÇ-së në zinxhirin e përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së ZÇ-së për çertifikimin e pagesave, si dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të përshkrimit të vendit të punës me objektivat e qarta dhe kriteret e performancës.

   Një rishikim i tillë duhet të bazohet në parimet dhe qasjet e mishëruara në sistemin e KBFP siç është specifikuar me politikën e re të KBFP, Rregullat e Thesarit dhe udhëzimet përkatëse. Përgjegjshmëria Menaxheriale duhet të promovohet njëkohësisht sikurse edhe zgjidhjet ekonomike.

2. Në periudhën afatshkurtër MEF-i duhet të dërgojë sinjale të qarta tek ministritë e linjës:

   (i) Të sqarohen detyrat specifike të ZÇ-së për ministritë individuale (përshkrimi i qartë i vendit të punës, ndarja e detyrave) duke përfshirë kërkesat lidhur me proceset e prokurimit; dhe
   (ii) Të dokumentohet puna e kryer e ZÇ-së dhe qëndrimi i tij si mbështetje thelbësore për nënshkrimin e dhënë.

MEF-ja ka hartuar një plan veprimi ku adresohen rekomandimet që i kemi dhënë.

Rekomandimet tek Kuvendi

Rekomandoj Kuvendin që të përcjellë implementimin e Planit të Veprimit dhe rezultatet prej tij.

5.7 Njësitë Qendrore Harmonizuese

Ekzistojnë dy Njësi Qendrore Harmonizuese. Njëra nga këto NjQH përkrah dhe përkujdesët për zhvillimin e Menaxhimit Financiar dhe të Kontrollit, ndërsa tjetra përkrah funksionimin efektiv të Auditimit të Brendshëm.

NjQH-ja për MFK-në është themeluar kohën e fundit dhe është në fazën e hershme të zhvillimit. Kjo NjQH është themeluar brenda Departamentit të Thesarit dhe i raporton Zv. Drejtorit të Thesarit.

NjQH-ja për AB-në është themeluar më herët dhe momentalisht është fokusuar për tu bërë qendër burimore për NjAB-të, duke i udhëzuar drejt efektivitetit më të lartë. Kjo NjQH-ë është pjesë e MEF-it dhe i raporton drejtpërdrejt Ministrit të Financave.

NjQH-ja për MFK-në përballet me sfidat në lidhje me metodat dhe qasjet e hartuara për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë disa paqëndrueshmëri midis niveleve të organizatës dhe vijave raportuese të këtyre dy NjQH-ve.

Rekomandime

- Menaxhmenti i Organizatave Buxhetore kanë nevojë që ta ndërrojnë filozofinë e menaxhmentit në mënyrë që ta përfshijnë KMF-në bërthamë të aktiviteteve të tyre;
- Programet për zhvillimin e objektivave të performancës duhet të themelohen të cilat i lidhin planet strategjike me buxhetet financiare dhe të cilat monitorojnë dhe ndihmojnë rezultatet operative;
- Procesi i filluar i reformave duhet të vazhdojë si dhe duhet të zhvillohet një proces transparent në lidhje me progresin e arritur për objektivat e planifikuara; dhe
- MEF duhet të analizojë përvojën e fituar nga zgjidhja aktuale organizative për NJQH/MFK me qëllim që ti sigurojë një përkrahje efektive për implementimin e mëtejshëm të konceptit të azhurnuar të MFK-së.

5.8 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Sistemi i kontrollit të brendshëm është një proces i vendosur nga menaxhmenti që është dizajnuar për të dhënë siguri në lidhje me arritjen e objektivave të mëposhtme organizative:

- efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve;
- raportim të besueshëm financiar;
- pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat; dhe
- mbrojtja e pasurisë.

Kontrolli i brendshëm përbëhet nga komponentët në vijim: mjedisi i kontrollit, vlerësimi i rrezikut, informacionit dhe komunikimit, veprimtaritë e kontrollit dhe monitorimit. Secila organizatë duhet të dizajnoj sistemin e saj të kontrollit të brendshëm dhe të siguroj zbatimin i tij në mënyrë që të arrij rezultatet e synuara.

Rezultatet tona të auditimit tregojnë se sistemet ekzistuese të kontrollit të brendshëm nuk janë efektive në arritjen e rezultateve të synuara.

Për shembull, ne kemi vërejtur se menaxhmenti i organizatave buxhetore nuk ka vendos elemente të nevojshme për të krijuar një mjedis të përshtatshëm të kontrollit. Mungojnë politikat e brendshme të shkruara dhe të doracakë të KB-së të nevojshme në nivel të entitetit derisa ekzistonte vetëm udhëzimi i përgjithshëm i nxjerrë nga Thesari. Nuk ka pasur përshkrime të qarta të punës për krijimin e detyrave si dhe pritjet e qarta nga zyrtarët që kanë të bëjnë me çështjet e financave.

Si pasojë e kësaj mungese të mjedisit të kontrollit, nuk ka pasur ndarje të duhur të detyrave që ka rezultuar në rastet e mundshme kur personi i autorizuar dhe ai miratues kanë qenë i njëjti person. Ne gjithashtu kemi gjetur raste kur personat e paautorizuar kanë pranuar mallrat e prokuruara dhe raste të tjera kur nuk kishte raport pranimi.

Ne gjithashtu kemi vërejtur dobësi në kontrollet e brendshme për sa i përket subvencioneve. Kemi gjetur raste të monitorimit të dobët mbi menaxhimin e tyre dhe raste kur subvencionet

janë përdorur për qëllime tjera e jo për qëllimet e destinuara dhe ku përfituesit e subvencioneve nuk kishin raportuar për përdorimin e tyre.

Ne gjithashtu kemi gjetur dobësi (e kemi paraqitur në seksionin tjetër) në kontrollet e brendshme që veprojnë për prokurim.

Sisteme të dizajnuara të KB-së me politikat e përcaktuara nuk funksionojnë si duhet në mënyrë që të plotësojnë objektivat e parapara me qëllim të parandalimit, zbulimit ose / dhe korrigjimit të gabimeve dhe parregullsive të mundshme. Këto KB nuk i ofrojnë menaxhmentit siguri të arsyeshme që menaxhimi financiar dhe aktivitetet operative janë në pajtim me kërkesat ligjore dhe arritjen e qëllimeve të synuara. Sistemet më të mira të kontrollit të brendshëm mund të sigurojnë rezultate më të mira operative dhe kosto më të ulëta.

Ndarja e Detyrave

Disa ministri në kuadër të tyre kanë institucione vartëse siç janë agjenci të ndryshme. Ndarja e detyrave dhe të përgjegjësive në nivelin e Zyrtarëve Kryesor Administrativ (ZKA) nganjëherë nuk është e qartë – veçanërisht në lidhje me përgjegjësitë, kompetencat dhe detyrat në raport me udhëheqjen financiare.

Pasqyrat financiare të Ministrisë dhe të Agjencive të ndryshme konsolidohen dhe nënshkruhen nga ZKF dhe ZKA (Sekretari i Përhershëm) i Ministrisë. Edhe agjencitë udhëhiqen nga këta zyrtarë (kryeshefi ekzekutiv i agjencisë) që kanë përshkrim të detyrave në nivel të njëjtë të përgjegjësive dhe të kompetencave të atyre që menaxhojnë dhe kontrollojnë Ministrinë.

Edhe pse ekzistojnë këta zyrtarë në Agjenci, ZKA dhe ZKF i Ministrisë përkatëse i nënshkruan PF-të e konsoliduara. Në këtë mënyrë, ZKA/ ZKF i Ministrisë përkatëse merr përsipër përgjegjësin për pasqyrat financiare të agjencisë edhe pse nuk janë nën menaxhim dhe mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të tyre.

Mungesa e udhëzimeve apo rregulloreve që i definon qartë detyrat dhe të përgjegjësitë e këtyre dy niveleve që në praktikë nuk duken gjithnjë të jenë të nivelit të njëjtë, dhe në disa mënyra nuk janë. Ky është burim i ngatërrimit të përgjegjësive.

Rekomandim

Rekomandojmë që Kuvendi të konsiderojë që të kërkojë një raport në fillim të vitit 2011 nga Ministri i MEF mbi veprimet e marra në lidhje me:

- Shqyrtimin e praktikave ekzistuese, sistemeve dhe proceseve që lidhen me kontrollet të MFK, duke synuar adresimin e dobësive në ato fusha të cilat kanë mangësi të rëndësishme;
- Nxjerrjen e shembujve të përgjithshëm të politikave dhe doracakëve të shkruara në mënyrë të qartë për menaxhim financiar dhe kontrolle duke vendosur procedura që duhet të përcillen nga zyrtarë kur kanë të bëjnë me financa;
- Vendosjen e udhëzime se si të prodhojnë përshkrime të qarta të punës që mbulojnë kërkesat për aftësi profesionale, njohuritë e pritura dhe kompetencat për zyrtarët e përfshirë në çështjet e financave;

- Dhënien e udhëzimeve se si të sigurojnë ndarjen e duhur të detyrave tek kontrollet operative të stafit, dhe
- Shqyrtimin e linjës së raportimit dhe përgjegjësisë për llogaridhënie në këto nivele menaxheriale me qëllim të qartësimit të përgjegjësive dhe kompetencave në këto dy nivele.

5.9 Prokurimi

5.9.1 Raporti i KRPP-së mbi Prokurimin Publik për vitin 2009

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) përgatit dhe i dërgon Qeverisë dhe Kuvendit raportin vjetor për çdo vit kalendarik. Për vitin 2009, KRPP-ja ka përgatitur Raportin dhe e ka dërguar atë hisedarëve.

Një çështje pozitive e përmendur në raport ishte niveli i lartë i përdorimit të procedurave të hapura gjatë vitit 2009 (diku 46%) në krahasim me vlerën e kontratave sipas procedurave të negociuara. Kjo nënkupton një trend në rritje drejt procedurave më transparente të prokurimit.

Në të njëjtën kohë, kemi vërejtur një rritje të dukshme të procedurës së kuotimit të çmimit në raport me vitin e kaluar (për 37%).

Puna jonë e auditimit në organizatat buxhetore ka treguar se ekziston një tendencë në rritje që ka të bëjë me shmangien nga procedurat e hapura. Gjithashtu kemi vërejtur edhe mangësitë në vijim:

- KRPP-ja ka prezantuar të dhënat mbi vlerën (shumën) e kontratave të nënshkruara sipas procedurave të prokurimit por nuk e ka paraqitur numrin e kontratave të nënshkruara;
- KRPP-ja nuk ka arritur të paraqesë numrin e ankesave nga operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese. APP-ja dhe OSHP-ja kanë shqyrtuar një numër të këtyre ankesave. Gjatë auditimit tonë të performancës në aneks kontratat, kemi gjetur se disa aneks kontrata (në vlerë prej 1,250,219€) nuk janë prezantuar në raportin vjetor të KRPP-së; dhe
- Gjithashtu, raporti vjetor i KRPP-së nxjerrë në pah mangësitë e mundshme në sistemin e prokurimit të cilat do të mund të ndiqen nga vet KRPP-ja në mënyrë që të përmbushen përgjegjësitë ligjore të këtij komisioni. Raporti ka rezultuar në 17 rekomandime në të cilat janë cekur masat që duhet ndërmarr me qëllim të përmirësimit të sistemit të prokurimit në tërësi.

Rekomandim

Rekomandojmë që KRPP-ja;

- Me qëllim që të siguroj besueshmëri të sistemeve të monitorimit dhe raportimit, KRPP-ja duhet të siguroj të ndërmerren veprime raportuese dhe pastaj adresuar mangësitë e mundshme. Kjo është e nevojshme në mënyrë që të siguroj mbështetje të duhur institucioneve qendrore të prokurimit publik në Kosovë.
- Të sigurojë mbikëqyrje të mjaftueshme lidhur me shfrytëzimin e aneks kontratave - duke i shmangur shpenzimet e tepërta të 10% tek ato kontrata ku është e mundur;
- Të angazhohet në forcimin e zbatimit të ligjit mbi prokurimin publik duke e ngritur vetëdijen lidhur me ligjin në mes të autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik në Kosovë;
- Të përgatit kornizë ligjore që do t'i rregullonte aktivitetet e prokurimit brenda kompanive të sektorit publik në bazë të urdhëresës të prokurimit të KE-së nr. 2004/17; dhe
- Të zhvillojë më tutje procesin e prokurimit publik përmes përdorimit të faqes zyrtare të internetit. Zhvillimet e tilla e rrisin transparencën në prokurimin publik duke mundësuar një qasje më të gjerë në të dhënat e prokurimit për të gjitha palët e interesuara.

5.9.2 Auditimet e ZAP-it mbi prokurimin për vitin 2009

Nga puna jonë audituese mund të thuhet se Organizatat Buxhetore nuk kanë dizajnuar kontrolle të mjaftueshme në menaxhimin e proceseve të prokurimit.

Menaxhimi i procedurave të prokurimit nuk ishte zhvilluar në pajtueshmëri të plotë me LPP-nw, dhe kishte të meta serioze prej fazës se inicimit të procedurave e deri të faza e ekzekutimit të kontratave. Kjo tregon një menaxhim jo të mirë të këtyre procedurave duke rrezikuar mosarritjen e vlerës së parasë të shpenzuar.

Me punën tonë të auditimit, kemi gjetur se mallra dhe shërbime të një cilësie jo të mirë do të mund të prokuroheshin.

Auditimet e vitit 2009 kanë hasur në probleme të njëjta që i kemi theksuar në raportet e auditimit për vitin 2008. Kjo tregon se organizatat buxhetore nuk kanë rishikuar plotësisht raportet tona të vitit 2008 dhe nuk i kanë adresuar rekomandimet e vitit 2008.

Në pjesën në vijim do të prezantojmë dobësitë e identifikuara në të gjitha auditimet individuale siç janë:

- Shpesh është bërë ndarje e blerjeve me qëllim të shmangies nga procedurat e hapura të blerjeve. Qëllimi i shmangies nga procedurat e hapura ishte eliminimi i konkurrencës, duke rezultuar në blerje me çmime me të larta dhe cilësi me të ulët;

- Mungesë e përcjelljes se implementimit të kontratave nga menaxherët e projekteve, P.sh. kemi parë kontrata ku ndëshkimet e aplikueshme nuk janë zbatuar për shkak të vonesave lidhur me kryerjes së punëve dhe shërbimeve;
- Kontratat shpesh janë dhënë edhe pse kërkesa për 3 oferta të veçanta nuk është respektuar. Fituesit e kontratave nuk kanë ofruar të gjitha dokumentet e kërkuara sipas dosjes së tenderit;
- Pagesat iu janë paguar kontraktuesve edhe pse puna apo shërbimi nuk është kryer në tërësi, apo para se të merret raporti (ato) janë nënshkruar;
- Realizimi i investimeve kapitale nuk është bërë në përputhje me planet për këto investime. Kjo tregon një menaxhim më të mirë të projekteve jo të planifikuar nga organizatat buxhetore, të cilët çojnë deri te mos përmbushja e objektivave të synuara;
- Për disa kontrata afatgjate për mallra dhe shërbime nuk janë përcaktuar sa duhet specifikacionet e nevojshme teknike. Si rezultat I kësaj organizatat buxhetore janë furnizuar me artikuj të pa kontraktuar. Mallrat dhe shërbimet e tilla jashtë kontratës fillestare mund të kenë çmime më të larta;
- Disa kontrata janë lidhur para se të sigurohen fondet e nevojshme. Kjo mungesë e menaxhimit të buxhetit rrit rrezikun që zotimet janë bërë pa pasur fonde për të paguar këto zotime. Kjo mund të rezultojë në mosmarrëveshje ligjore dhe mund të dëmtoj besimin e operatorëve ekonomik për të lidhur marrëveshje me sektorin e Qeverisë;
- Pranimi i mallrave, shërbimeve kontraktuese dhe i punëve nga personat e paautorizuar. Kjo shpie deri te rreziku i pranimit të mallrave, shërbimeve apo punëve të cilat nuk i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në kontratë, apo krijon mundësi për keqpërdorim dhe në veçanti manipulim të sasive të pranuara; dhe
- Kemi vërejtur që Ministritë kanë aplikuar fonde rezervë për kontrata të caktuara të cilat kanë elemente të paparashikueshme në përqindjet e 2%, 5% të vlerës së kontratës. Vlera e këtij fondi rezervë që është marrë së bashku më vlerën e aneks kontratës e tejkalon tepricën e 10% të lejuar me kontratë.

Konkluzionet

Aktivitetet e prokurimit tregojnë për një shumë të konsiderueshme të shpenzimeve publike. Sistemi i prokurimit në sektorin publik nuk funksionon si duhet si dhe ka një varg mangësish. Këto ekzistojnë në mjedisin e kontrollit të përgjithshëm dhe nivelin e kontrolleve të brendshme të themeluara nga organizatat buxhetore. Sistemi i prokurimit nuk ka ofruar bazë të mirë për të arritur vlerën për para.

Kontrollet në nivelin menaxherial brenda organizatave buxhetore nuk janë zhvilluar sa duhet. Menaxheret e organizatave buxhetore nuk janë angazhuar sa duhet në zhvillimin e procesit të prokurimit. Si rezultat i kësaj, ata në përgjithësi nuk angazhohen në procesin e monitorimit dhe kontrollit të tyre në mënyrë që të sigurohet zgjidhje e cilësisë së lartë të shpenzimeve të ulëta. Kjo situatë lidhet me faktin se ideja e përgjegjësisë menaxheriale brenda organizatave buxhetore nuk është avancuar sa duhet. Menaxherët nuk e kuptojnë se duhet të jenë përgjegjës për përdorimin ekonomik, efikas dhe efektiv të burimeve publike.

Rekomandime

Unë rekomandoj Kuvendin të përcjellë me kujdes implementimin e Ligjit të ri të Prokurimit, veçanërisht në lidhje me:

- Një mekanizëm ku veprojnë llogaridhënia dhe kontrolli. Detyrat e qarta dhe theksi mbi përgjegjësinë individuale do te sigurojë shfrytëzim efikas të parasë publike,
- Transparencën dhe konkurrencën e barabartë e cila trajton të gjithë operatorët në mënyrë të drejtë dhe të barabartë;
- Sigurimin që organizatat buxhetore të ndjekin proceset e prokurimit siç janë përshkruar në kornizën legjislative duke filluar nga inicimi i proceseve dhe vazhduar përmes nënshkrimit dhe mbikëqyrjes së kontratave; dhe
- Funksionin e mbikëqyrjes se implementimit të projekteve të cilët duhet të sigurojnë që mallrat, shërbimet apo punët e kontraktuara të jenë të realizuara në përputhje me sasitë dhe cilësitë e kontraktuara.

5.10 Burimet Njerëzore

Rregullorja mbi Pagat

Mosrespektimi i rregulloreve (2001/36 dhe 2003/3) mbi pagat dhe mëditjet ka shkaktuar pagesën e pagave pa bazë të mjaftueshme ligjore. Për këtë është BKK-ja ngarkuar në mënyrë direkte.

Pas ekzaminimit të tërësishëm të raporteve të auditimit dhe analizimin e secilit raport veç e veç, kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- sistemin e pagave;
- procedurat e rekrutimit;,
- mirëmbajtjen e dosjeve të personelit;,
- krijimin e politikave të brendshme; dhe
- kontratat e punësimit.

Procedurat e Rekrutimit

Procedurat e rekrutimit janë anashkaluar nganjëherë gjate implementimit. Në disa raste institucionet nuk i respektojnë kriteret e vendosura kur bëhet përzgjedhja e kandidatëve. Përveç kësaj, shpesh vërejmë mangësi formale si:

- Mungon kërkesa për inicimin e rekrutimit;
- Shpallja për pozitën nuk është vënë në dosjen e rekrutimit;
- Kriteret e shpalljes së pozitave nuk janë përgatitur mirë; dhe
- Në dosje mungon përshkrimi i qëllimit të punës dhe detyrat kryesore dhe përgjegjësitë.

Më tej, në shumë procese të rekrutimit mungojnë dokumentacione të duhura pas finalizimit.

Mirëmbajtja e të dhënave të personelit

Mirëmbajtja e të dhënave të personelit shpesh i tregon mangësitë si:

- Kontratat e punës nuk janë rinovuar, as nënshkruar nga të dy palët apo janë pa numër;
- Mungojnë dokumentet e kualifikimit të duhur;
- Të dhënat për pushime;
- Të dhënat e kontrollit mjekësor;
- Dokumentacioni i duhur me rastin e avancimit të stafit;
- Përshkrimi i vendit të punës; dhe
- Vlerësimi i performancës së stafit, etj

Është detyrë e çdo menaxheri të sigurojë që të gjitha të dhënat e personelit të mbahen dhe rinovohen sipas rregulloreve në fuqi. UA i MAP/DASHC nr. 2003/11 mbi të Dhënat e Personelit definon qartazi direktivat për mënyrën e mbajtjes se tyre.

Krijimi i politikës së brendshme

Jo në shumë raste politikat e brendshme mungojnë, nuk janë rinovuar, ose vetëm janë kopjuar dhe barten nga materialet e nivelit qendror. Në rastin e fundit nevojat specifike të institucioneve nuk janë marrë në konsideratë. Kjo nganjëherë çon në delegim te paqartë të detyrave, mospërputhje lidhur me përshkrimin e punës, paqartësi rreth parashikimeve nga zyrtarët në fjalë, etj.

Më pastaj kemi vërejtur se disa institucione nuk kanë kryer vlerësimin e përformancës së stafit dhe se shumë dokumente mungojnë për këto të dhëna personale.

Punësimi dhe kontratat mbi vepër

Shumë institucione i përdorin kontratat mbi vepër për të mbuluar boshllëqet e personelit në shumë fusha. Një tjetër mangësi është trajtimi i kontratave të punës. Shumë institucione kanë probleme me kontrata të rinovuara me kohë dhe plotësimin e kërkesave bazë lidhur me përdorimin e një numri unik për çdo kontratë dhe çdo vend pune.

Ne besojmë se harmonizim ndërmjet institucionit dhe sistemit të pagave duhet të kryhet ashtu që kur kontrata e një stafi skadon, paga e të njëjtit të stopohet gjithashtu, dhe në këtë mënyrë do të iniciohet përcjellja e duhur e kontratave.

Konkluzionet

Menaxhimi me burime njerëzore dhe sistemit të pagave janë aspekte të rëndësishme në përpjekjet për të arritur objektivat dhe zhvillimit të qeverisjes së mirë.

Menaxhimi me burime njerëzore duhet të ndryshoj në shumë mënyra. Pritjet publike të niveleve shërbyese do të vazhdojnë të rriten. Institucionet duhet të jenë në gjendje të vazhdojnë t'i tërheqin njerëzit e talentuar dhe të përkushtuar që mund të japin vlerën për para.

MAP është përgjegjës për mbikëqyrje dhe ndihmë në reforma në fushat e përmirësimit të sistemeve, shkathtësive dhe aftësive për të ofruar shërbime relevante dhe të duhura publike.

Menaxhimi i mirë është bazë për ndryshime efektive. Institucionet duhet të angazhohen në përmirësimin e udhëheqjes në të gjitha nivelet, dhe të bëhen institucione ku udhëheqësit udhëheqin më shembuj personal dhe i frymëzojnë të tjerët.

Rekomandim

- MAP duhet të forcojë mënyrën e zakonshme të kontratat mbi pagat; dhe
- MAP duhet të forcojë procedurat për realizimin dhe monitorimin e pagesës së pagave.

5.11 Menaxhimi i pasurisë fikse

Objektivi pas menaxhimit të pasurisë së Qeverisë është për t'iu mundësuar organizatave buxhetore:

- Sigurimin e menaxhimit efektiv të pasurisë së Qeverisë;
- Mbajtjen e të dhënave të sakta të të gjitha pasurive përmes mirëmbajtjes sistematike të regjistrit të pasurive si pjesë integrale e SIMFK-ut me qëllim të vlerësimit dhe raportimit të vlerave të tyre; dhe
- Procesin e duhur, efikas dhe transparent të tjetërsimit të pasurisë.

Organizatat buxhetore obligohen të mbajnë regjistrat e pasurive dhe vazhdimisht të bëjnë ri-përtëritjen e tyre në sistemin e Free Balance-it të Thesarit sipas Udhëzimit Administrativ nr. 21/ 2009 mbi Menaxhimin e pasurive të Qeverisë.

Gjatë auditimit kemi vërejtur se entitetet nuk kanë vepruar në përputhshmëri të plotë me Udhëzimin Administrativ mbi Menaxhimin e Pasurive të Qeverisë.

Të gjeturat kryesore në menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive në disa organizata buxhetore të identifikuara janë në vijim:

- Regjistrat jo të plotë të pasurive;
- Mos mbajtja e të dhënave të sakta të pasurive në shënimet kontabël të Free Balance
- Mungesa e regjistrit të pasurive;
- Zhvlerësimi i pasurive i pakryer; dhe
- Zyrtari i pasurive nuk i raporton Zyrtarit Kryesor Financiar.

Gjatë vitit 2009, OB-të nuk e kanë kryer regjistrim të plotë të pasurive që do t'i parandalonte keqpërdorimet apo humbjet e pasurive.

Disa organizata kanë themeluar komisionet për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurive, por nuk kanë përgatitur ndonjë raport lidhur me performancën e tyre. Për më tepër, disa organizata nuk kanë themeluar fare këto komisione siç kërkohet me Udhëzimin Administrativ.

Rekomandim

Rekomandojmë organizatat buxhetore dhe MEF-in që të sigurojë se do të:

- Mbahet regjistri i plotë dhe i saktë i pasurive në aspektin financiar dhe sasior;
- Mbahen të dhënat të pasurive në regjistrin kontabël të Free Balance-it;
- Llogaritet zhvlerësimi i pasurive konform normave të caktuara;
- Emërohen zyrtarët e pasurive nën autoritetin e zyrtarit kryesor financiar; dhe
- Themelohen komisionet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të organizatave buxhetore në përputhje me UA nr. 21/2009 mbi Regjistrimin dhe Menaxhimin e Pasurive të Qeverisë.

Rekomandojmë MEF-në që të sigurojë se:

- Arsyet për mangësitë në menaxhimin e pasurive analizohen si duhet; dhe
- Organizatat Buxhetore i adresojnë rekomandimet e përmendura më lart në mënyrë të mjaftueshme dhe raportojnë mbi progresin e bërë.

Pasuritë Jo financiare

Udhëzimi Administrativ nr. 20/2009 i nxjerrë në dhjetor të vitit 2009 mbi raportimin vjetor përcakton se të gjitha organizatat buxhetore obligohen ta regjistrojnë vlerën e pasurive të tyre jo financiare në SIMFK dhe të përfshihen në PF.

Gjatë testimit të PF-ve të BKK-së kemi vërejtur që shumica e organizatave buxhetore nuk kanë raportuar për këtë lloj të pasurive në vlerën e objekteve të tyre, disa prej të cilave janë: ndërtesa e Qeverisë, ajo e ASHAK-ut, ndërtesa e Rilindjes, ndërtesa e Avokatit të Popullit të Kosovës, Universitetit të Prishtinës, etj.

Pasuritë tjera të pa prezantuara në PF ishin tokat dhe fushat tjera në pronësi të këtyre organizatave.

Sipas disa institucioneve, një nga arsyet e mos raportimit është për shkak të përcaktimit të paqartë të pronarit dhe trashëguesit të pasurisë, ku këto vështirësi u trashëguan nga sistemi i mëparshëm i Jugosllavisë. Megjithatë, një angazhim edhe më serioz i menaxhmentit të këtyre organizatave do të mundësonte gjetjen e metodave për shpalosje më të mirë të pasurive financiare.

Konkluzion

Prezantimi jo i duhur dhe i pasaktë i pasurive jo financiare në PF-të e organizatave buxhetore dhe në PF-të e BKK-së ka rezultuar në nënvlerësim material të pasurive publike.

Rekomandim

Rekomandojmë Kuvendin të kërkojë që:

> Qeveria të marrë masa për të siguruar që këto lloje të pasurive të trajtohen me kujdes dhe se çështja e pronësisë të adresohet si duhet. Në të njëjtën kohë, Qeveria duhet të ofrojë raportim të plotë dhe të saktë të të gjitha niveleve të këtyre pasurive.

5.12 Paraja e imët (Petty cash-i)

Paraja e imët menaxhohet në mbështetje të LMFPP-së si dhe Rregullave të tjera financiare, ndër të cilët është Udhëzimi dhe Rregulla financiare 02 e Thesarit - Shpenzimi i Parave Publike.

Organizatat buxhetore mbajnë shuma të vogla parash të gatshme më qëllim të mbulimit të nevojave të paparashikuara në vlera të vogla.

Vlera e parasë se imët e shpenzuar në buxhetin e përgjithshëm të vitit 2009 kap shumën prej 752,058€. Shuma e shpenzimeve të parasë se imët ndryshon në organizatat buxhetore varësisht nga nevojat e tyre gjatë vitit. Disa OB kanë vlerë më të lartë të shpenzimeve të parasë së imët për arsye se kanë shumë agjenci vartëse ku një fond i tillë alokohet.

Auditimi i ynë ka paraqitur mangësitë e mëposhtme në menaxhimin dhe shfrytëzimin e parasë së imët:

> - Paraja e imët është përdor për qëllime të cilat kishin mundur të bëhen përmes kanaleve normale – p.sh. janë paguar fatura për mallra dhe shërbime për të cilat veçse kishte pasur kontrata të lidhura; Vërehet rreziku shumë më i madh tek shfrytëzimi i parave të imëta në vend se pagesat normale përmes bankës - pagesat duhet të bëhen vetëm nga paratë e imëta në qoftë se nuk ka metodë tjetër; dhe
> - Kemi gjetur raste kur vlera e pagesave për qëllime të njëjta tejkalonte vlerën prej 100€. Gjithashtu kishte raste ku shpenzime të ndryshme të parasë së imët ishin regjistruar si kategori e shpenzimeve tjera, në vend se të ishin ndarë me kod të rregullt buxhetor.

Konkluzion

Ende ka hapësirë për përmirësim të menaxhimit të parasë së imta. Një planifikim më rigoroz i menaxhmentit do të ulte nevojën për paranë e imët. Ka dëshmi të pagesës së kësaj paraje që do të ishte trajtuar më mirë përmes proceseve normale të prokurimit – duke cekur qartë se paraja e imët nuk është shpenzuar në pajtim me kornizën ligjore.

Rekomandim

Rekomandojmë Qeverinë e Kosovës të:

- analizoj sistemin e menaxhimit të shpenzimeve të parasë së imët për të siguruar se këto para përdorën në përputhje me nevojat reale të OB-ve dhe nuk janë objekt i përdorimit të gabuar për qëllime të pa mbështetura.

5.13 Auditimi i brendshëm

Raporti i dytë vjetor nga NjQH/AB mbi funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm të sektorit publik për vitin 2009 është dërguar në mars 2009. Në raport ceken zhvillimet në fushën e auditimit të brendshëm, aktivitetet, opinionet dhe rekomandimet e NjQH/AB mbi funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm të sektorit publik (duke përjashtuar ndërmarrjet publike).

Në raport përmenden arritjet dhe përmirësimet gjatë vitit 2009:

- Dekret ligji mbi auditimin e brendshëm;
- Nxjerrja e një udhëzimi administrativ mbi themelimin e NjAB-it dhe ai mbi licencimin e përkohshëm të auditorëve të brendshëm. Këto udhëzime janë aprovuar nga Ministri në dhjetor 2009.

Zhvillime tjera pozitive në vitin 2009 kanë qenë: krijimi i njësive të reja të auditimit, rritja e numrit të komisioneve të auditimit, rritja e numrit të auditorëve të brendshëm, ndërtimi i kapaciteteve profesionale të auditorëve të brendshëm dhe bashkëpunimi më i madh me ZAP-in dhe hisedarët tjerë.
Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ishte fillimi i një trajnimi ndërkombëtar dhe programi certifikues për auditorët e brendshëm i financuar nga Unioni Evropian në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht.

Ky raport i merr parasysh fushat në të cilat duhet të ketë përmirësime:

- NjAB-i duhet të formohet në të gjitha entitetet publike;
- Shumica e NjAB-ve kanë mungesë të burimeve të duhura njerëzorë për funksionim të një auditimi të brendshëm efektiv:
- Duhet të formohen komisionet e auditimit në të gjitha entitetet publike; dhe
- Nevojitet një angazhim në rritje i menaxhmentit të lartë në transparencën e auditimit të brendshëm, llogaridhënies dhe autoritetit për menaxhimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Në vitin 2009 janë vërejtur përmirësime në zhvillimin e sistemeve të auditimit të brendshëm. Megjithatë zhvillimi i menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit ka qenë i ngadalshëm dhe është larg progresit të arritur në sistemet e auditimit te brendshëm.

Auditorët e brendshëm dhe menaxhmenti përcaktojnë ku të fokusohen përpjekjet e auditimit të brendshëm duke e konsideruar si vlerësim të rrezikut të organizatës dhe organeve

mbikëqyrëse të saj. Meqenëse menaxhimi i rrezikut nuk është zhvilluar në shumë institucione të Kosovës, në këtë rast auditorët e brendshëm nuk janë në gjendje t'i gjykojnë rreziqet e identifikuara nga menaxhmenti dhe duhet t'i planifikojnë auditimet e tyre duke u marrë me vlerësim më të gjerë të rreziqeve.

Është aprovuar ligji i ri për auditimin e brendshëm, por ende ka disa mangësi dhe mospërputhje të cilat nuk janë në harmoni me praktikat e mira.

Funksionimi i NjAB

Kemi gjetur mungesë të stafit në NJAB-të e entiteteve të audituara dhe kjo është zakonisht për shkak të problemeve buxhetore dhe humbjeve në sektorin publik. Nevojiten përpjekje shtesë për të siguruar stafin adekuat.

Planet e Auditimit

Një NjAB efektiv duhet t'i zbulojë rreziqet duke u bazuar në planet e auditimit. Kemi vërejtur se gati të gjitha NjAB-të kanë përgatitur plane strategjike dhe vjetore të auditimit duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut të kryer nga vetë NjAB-të. Mirëpo cilësia e këtyre planeve ka nevojë për përmirësim dhe duhet të aplikohen në mënyrë më specifike në bizneset të cilat i auditojnë.

Në shumë raste planet e NjAB janë pa objektiva të qarta, zonat e rrezikut të lartë identifikohen rrallëherë dhe nuk ka fokusim ndaj sfidave të organizatës. Në këtë fazë NjAB-të nuk mund të konsiderohen se janë mjete të forta në dispozicion të menaxhmentit për monitorimin e menaxhimit financiar dhe kontrolleve të përgjithshme.

Sigurimi efektiv i mbulimit të rrezikut është esencial për të siguruar organizatën se menaxhimi i rrezikut, qeverisjen dhe proceset e kontrollit të brendshëm funksionojnë si duhet dhe se objektivat e organizatës janë duke u realizuar.

Rishikimi i raporteve të auditorëve

Ne kemi shqyrtuar një numër të madh të raporteve të AB-së. Në shumë raste kemi gjetur se raportet e NjAB-it kanë mbuluar vitin 2008 dhe në disa raste kanë mbuluar edhe 2007. Viti 2009 ishte periudha më pak e audituar. Një fokusim i tillë ul vlerën e raporteve të AB dhe na parandalon ne si auditor të jashtëm të kemi besim në punën NjAB-së.

Në të njëjtën kohë, vërejmë që shumë çështje janë ngritur në raportet e AB-së dhe janë dhënë rekomandime të duhura rreth tyre. Përderisa disa nga ato rekomandime janë adresuar nga menaxhmenti, por kemi vërejtur se një numër i konsiderueshëm i tyre mbesin pa u adresuar. Mungesa e komisioneve të auditimit në disa entitete ka ngadalësuar adresimin e rekomandimeve të mëhershme të AB-së .

Me qëllim që të përmirësohet sistemi i MFK-së , është thelbësore që rekomandimet e NjAB të adresohen brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Aftësia e Auditorit të brendshëm dhe arsimimi i vazhdueshëm profesional (AVP)

Shumica e auditorëve të brendshëm kanë ndjekur trajnime profesionale në dy projektet e financuara nga BE-ja. Është arritur një progres i konsiderueshëm në finalizimin e fazës përgatitore për "programin e trajnimit të auditimit të brendshëm dhe certifikimit" për 2010.

Konkluzion:

Në vijim i paraqesim konkluzionet e përgatitura mbi AB-në

- Auditimi i brendshëm ende ka nevojë të përmirësohet. Përderisa shohim shenja inkurajuese të progresit, sistemet e menaxhimit/kontrollit janë ende të dobët dhe në fazën fillestare të zhvillimit të tyre;
- Progres për formimin e komisioneve të auditimit ka nevojë të përmirësohet. Vërehet një rritje e ndjeshme se formimi i një KA-je në çdo organizatë buxhetore mund të mos jetë efikas dhe shumë i kushtueshëm.
- Ne ende nuk jemi në gjendje t'i besojmë aktiviteteve të NJAB-it për të siguruar auditim lidhur me sistemet e kontrollit të brendshëm dhe aplikimit të tyre
- Në disa komuna, entitet të vogla dhe në Ministrinë e Transportit dhe Post Telekomunikacionit nuk ka NJAB nuk kanë qenë të themeluara ose nuk kanë pasur staf.
- Në përgjithësi, kapaciteti i auditimit të brendshëm i shumë entiteteve ende është i pakënaqshëm.
- Auditimet e kryera në bazë të planifikimeve të auditimit të brendshëm nuk i japin përparësi proceseve me rrezik të lartë.

Rekomandim:

Rekomandojmë që Kuvendi:

- Të ndjekë në mënyrë aktive implementimin e Ligjit mbi MFPP-ën dhe organizojë seanca dëgjimore me MEF-in dhe Kuvendin me qëllim të zhvillimit të këtij instrumenti shumë të rëndësishëm të kontrollit, dhe

Rekomandojmë që MEF dhe NjQH/AB-ja të:

- Vlerësojnë më thellësisht performancën e operimit të auditorëve të brendshëm në raport me konkluzionet e auditimit të jashtëm;
- Rishikojnë punën e komisioneve të themeluara të auditimit dhe t'iu ofrojë shembuj të mirë, praktika të mira rreth metodës, etj;
- Rishikojnë ligjin e tanishëm mbi Auditimin e brendshëm për t'i eliminuar mospërputhjet e mbetura me standardet ndërkombëtarë dhe praktikat e mira; dhe
- Përmbledhë të gjeturat e auditimit të brendshëm më qëllim të identifikimit të mangësive dhe rekomandimeve të përbashkëta për të identifikuar sfidat e shkaktuara nga korniza aktuale ligjore dhe praktikat në përdorim.

Rekomandojmë që NjAB të:

- Marrë rol aktiv për të ndihmuar menaxhmentin e tij në implementimin e menaxhimit të rrezikut dhe sistemeve kontrolluese;
- Zhvillojë edhe më tej analiza të rrezikut që i përshtatet bizneseve specifike dhe të kryej funksionin duke u bazuar në to;
- Përmirësojë cilësinë e dosjeve të auditimit të brendshëm;
- Krijojë lidhje ndërmjet Drejtorëve të tij me menaxhmentin dhe komisionet e auditimit në mënyrë që të siguroj rezerva adekuate;
- Vet NjAB dhe menaxhmenti duhet të pajtohen me planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve të raporteve të dala nga auditimi i brendshëm dhe të krijojë mekanizma të cilët sigurojnë që këto rekomandime të adresohen; dhe
- Përgatitë planet vjetore të auditimit të cilët japin kohë për rol konsultativ të AB dhe nevojave të trajnimit të vet AB-ës, si dhe për funksionin kryesor të ofrimit të këshillave shtesë që i japin përparësi fushave me rrezik të lartë të biznesit.

6 Ndërmarrjet Publike dhe Shoqërore

Ndërmarrjet Publike u riorganizuan si Shoqëri aksionare si pjesë e procesit të "korporatizimit" nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Pas këtij korporatizimi, AKM-ja angazhoi një firmë të huaj auditimi për të vlerësuar pasuritë e NP-ve. Kjo ju dha atyre një shifër për hapjen e bilanceve të tyre.

Pas shuarjes se funksionimit të AKM-së në Qershor të vitit 2008, Ndërmarrjet Publike kalojnë në menaxhimin e Republikës së Kosovës dhe MEF-it. Në të njëjtën kohë, ishte themeluar Agjencia Kosovare e Privatizimit e cila kishte për detyrë menaxhimin dhe privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore.

Ndërmarrjet Publike

Pas transformimit të NP-ve nga subjektet me pronësi shoqërore në Shoqëri Aksionare, Kuvendi i Republikës se Kosovës ka nxjerrë Ligjin për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087 . Ky ligj krijon kornizën ligjore për rregullimin, funksionimin e të drejtave pronësore në ndërmarrjet publike,

NP-të janë kategorizuar si

- Ndërmarrje Publike Qendrore dhe Rajonale; dhe
- Ndërmarrje Publike Lokale.

Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Rajonale janë në pronësi të Republikës së Kosovës përmes MEF-it që zotëron 100% të aksioneve.

Në listën e parë të NP-ve bëjnë pjesë tetë NP-të Qendrore, dy kompani rajonale të ujitjes dhe gjashtë kompani rajonale të ujësjellësit.
Në kuadër të NP-ve qendrore cilësohet edhe RTK-ja e cila ka një pozitë të veçantë pasi që është e themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe statusi i saj është përcaktuar me Ligjin mbi RTK-në.

Ndërmarrjet Publike Lokale janë në pronësi të komunës apo komunave siç është përcaktuara me këtë ligj. Në listën e NP-ve lokale bëjnë pjesë 16 NP Lokale të cilat qeverisen nga komunat varësisht nga përqindja së pronësisë së aksioneve.

Me qëllim të mbështetjes se MEF dhe Qeverisë në ushtrimin e përgjegjësive mbi NP-të është themeluar Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJMNP).

Kjo njësi i raporton Ministrit rreth performancës së NP-ve Qendrore dhe Ministri raporton në Qeveri dhe Kuvend.

Po ashtu kjo njësi ka përgjegjësi të publikoj në faqen e saj në internet të gjitha informatat, raportet, deklaratat financiare duke përfshirë edhe statutin, rregulloret dhe Planin e Biznesit të NP-ve.

NP-të ndjekin kërkesat e raportimi financiar për shoqëritë aksionare sipas ligjit mbi Shoqëritë Tregtare. Po ashtu sipas ligjit për NP-të, ato duhet të veprojnë në përputhje të plotë me Udhëzimet Administrative të nxjerra nga Thesari për përgatitjen e raporteve financiare të cilat kërkohen nga LMFPP-ja.
Ligji mbi Ndërmarrjet Publike kërkojnë që Pasqyrat Vjetore Financiare të auditohen nga një auditor i jashtëm i caktuar nga ndërmarrja. Sipas mendimit tonë, ky regjim nuk është mjaft transparent dhe në pajtim me standardet e njohura ndërkombëtarisht.

Ne e kemi mandatin ligjor për të audituar NP-të. Këtë autoritet na e jep Kushtetuta dhe Ligji mbi Themelimin e Zyrës se Auditorit të Përgjithshëm.

Në kuadër të NP-ve Qendrore ne kemi audituar pasqyrat financiare të KUR "Prishtina" për vitin 2009, si dhe një auditim për adresimin e rekomandimeve të RTK-së, të dala nga raporti i auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2008.

Ndërsa te NP-të Lokale kemi audituar pasqyrat financiare të kompanisë së mbeturinave "Pastrimi", si dhe auditimi i menaxhimit financiar të Ngrohtores së Qytetit "Termokos".

Auditimi i këtyre NP-ve rezulton në të gjeturat në vijim:

- Ndërmarrjet Publike nuk kanë pasur monitorim efektiv vjetor. Njësia për Politika dhe monitorimin e NP nuk i ka dorëzuar Qeverisë analiza të kërkuara, raporte dhe rekomandime lidhur më performancën e tyre. Qeveria nuk i ka konsoliduar rreziqet financiare në një raport vjetor për NP-të.
- Ligji i NP-ve nuk është shumë i qartë në çështjet e raportimit. Sipas këtij Ligji, NP-ët duhet të raportojnë në pajtim të plotë me Ligjin mbi Shoqëritë Tregtare dhe sipas kërkesave të LMFPP-së. Këto dy ligje ndryshojnë njëra me tjetrën sa i përket parimeve të kontabilitetit;
- Ligjim mbi NP-ët kërkon që NP-të t'i respektojnë aktet nënligjore, kodet dhe rregulloret e MEF-it. Mirëpo MEF-i nuk ka arritur t'i nxjerrë këto udhëzime. Po ashtu në kuadër të NP-ve mungon një manual standard lidhur me auditimin e brendshëm, pasi që Ligjin mbi Auditimin e Brendshëm nuk e aplikojnë NP-të;
- Ekziston një keqkuptim se si NP-të të veprojnë me TVSH-në. Rregulloret e vendit përcaktojnë se TVSH-ja duhet të regjistrohet në momentin e faturimit, ndërsa nga praktika tregohet se NP-të e regjistrojnë në momentin e inkasimit të të hyrave. Një udhëzim memorandumi ndërmjet MEF-it dhe AKM-së është lëshuar lidhur me këtë çështje por është aplikuar vetëm gjatë vitit 2008;
- Inkasimi i ultë i mjeteve dhe trajtimi jo i duhur i borxheve tregohet se i përcjellë të gjitha NP-të. Si rrjedhojë provizionohen ose shlyhen vlera të larta të borxheve e cila bie në kundërshtim me Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjet e aplikueshme në vend;

- Zhvlerësimi i pasurisë është çështje e pazgjidhur në mes të kompanive publike dhe ATK-ës. Siç është cekur më lartë AKM-ja kishte angazhuar kompani të jashtme të auditimit për vlerësimin e pasurisë si pjesë e procesit të korporatizimit, në bazë të cilit është bërë hapja e llogarisë së pasurive. Mirëpo këtë vlerësim nuk e pranon ATK-ja, pasi që në Kosovë asnjë institucion nuk ka licencë për vlerësimin e pasurisë; dhe
- MEF-i nuk e trajton në mënyrë të barabartë çështjen e subvencionimit të NP-ve. P.sh. KEK-u merr subvencione për rastet sociale, kurse NP-të tjera nuk kanë marrë.

Konkluzione dhe rekomandimet e dhëna

Qeveria nuk e monitoron performancën e NP-ve në mënyrë të duhur dhe ato nuk menaxhohen në nivel të kënaqshëm. Sistemi i dobët i kontrollit, humbjet e vazhdueshme operative dhe grumbullimi jo i duhur i borxheve të papaguara ndikojnë në krijimin e rreziqeve financiare për Qeverinë lidhur me NP-të.

Mbledhja e të dhëna vjetore për NP-t është jo adekuate. Pa informata të sakta Qeveria nuk është në gjendje të fitoj një kuptim të performancës se NP-ve apo të kuptojë dhe menaxhojë rrezikun e përgjithshëm fiskal.

Qeveria nuk ka arritur ti monitorojë të gjitha rreziqet financiare të NP-ve dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme në përputhje me parimet e transparencës, qeverisjes dhe llogaridhënies, dhe në përputhje me përgjegjësitë relative që ka Qeveria ndaj NP-ve.

Rekomandojmë që Ministri i MEF-it të:

- Monitoroj NP-ët në përputhje me kornizën aktuale ligjore dhe të ndërmarrë veprime përmirësuese të cilat do të ndihmojnë NP-ët në arritjen e objektivave të përcaktuara;
- Rishikojë NP-të në ato fusha me mangësi të theksuara dhe të nxjerrë të gjitha modelet e rregulloreve të cilat do të ndihmojnë NP-ët në funksionimin e tyre - duke përfshirë kontrollet e brendshme operative si funksion i auditimit të brendshëm;
- Zgjidhë çështjet aktuale të NP-ve rreth trajtimit të arkëtueshmëve, TVSH-së dhe vlerësimit të pasurive duke punuar së bashku me ATK-në në gjetjen e një zgjidhje për këto çështje; dhe
- Nxjerrë politika të qëndrueshme përmes NP-ve rreth subvencioneve duke i trajtuar të gjitha NP-të në mënyrë transparente dhe të barabartë

Ndërmarrjet Shoqërore

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ishte themeluar në bazë të Ligjit Nr: 03/L-067. Funksioni i AKP-ës është administrimi dhe privatizimi i NSH-ve.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të AKP-ës për vitin 2009, si dhe kemi bërë një auditim të veçantë për pasqyrat financiare të Fondit të Privatizimit për periudhën 1 Tetor 2007 deri më 31 Dhjetor 2009.

Fondi i Privatizimit

Tabela 4 ***Pasqyra e Fondit të privatizimi për periudhën 01 tetor 2007 deri me 31 dhjetor 2009***

Përshkrimi i Llogarive	Llogaritë aktive në fund të periudhës	Gjendja e Llogarive më 1 Tetor 2007	Gjendja e Llogarive më 31 Dhjetor 2009	Diferenca
Llogaritë e Privatizimit në mirëbesim	621	268,976,128	259,719,544	-9,256,584
Llogaritë e Likuidimit në mirëbesim	121	62,652,543	175,188,793	112,536,250
Llogaritë (Paratë) në mirëbesim të NSH-ve	96	4,661,885	3,388,895	-1,272,990
Parat në mirëbesim të komercializimit të NSH	16	1,661,718	3,567,460	1,905,742
Mjetet e mirëbesimit që u takojnë punëtorëve	21	227,990	132,986	-95,004
Depozitat e Ofertave të Privatizimit	1	5,157,229	3,391,091	-1,766,138
Tarifat e Dorëzimit të Ofertave në Privatizim	1	874,914	1,428,339	553,425
Depozitat e Ofertave të Likuidimit	1	2,105,072	638,468	-1,466,604
Tarifat e Dorëzimit të Ofertave në Likuidim	1	65,917	49,642	-16,275
Kapitali Themeltar i AKP-së	1	1,073,815	1,094,207	20,392
Fondi Rezerve i AKP-së	1	1,379,034	2,433,523	1,054,489
Parat e Donatorëve	1	8,028	8,347	319
Totali:	**882**	**348,844,273**	**451,041,297**	**102,197,024**

Nga tabela më lartë shihet gjendja e të gjitha llogarive në fund të periudhës raportuese, duke përfshi edhe numrin e llogarive aktive. Mjetet e fondit të privatizimit gjatë kësaj periudhe janë rritur për 102,197,024€, që është si rezultat i procesit të privatizimit.

Deri në fund të vitit 2009 ende nuk ka filluar procesi i likuidimit të NSH-ve. Ky proces ka filluar në fillim të vitit 2010.

Në auditimin e Pasqyrave të Fondit të Privatizimit ne kemi nxjerrë të gjetura dhe konkluzione për administrimin dhe privatizimin e NSH-ve nga AKP-ja.

Dobësitë kryesore në menaxhimin e këtij fondi lidhen me monitorimin e ndërmarrjeve të privatizuara me Spin-Off special, si dhe me zvarritjen në përmbylljen (nënshkrimin) e kontratave.

Po ashtu janë identifikuar dobësi lidhur me kundërthëniet në mes të politikave operacionale të AKP-së dhe rregullave të tenderit, si dhe dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Konkluzione dhe rekomandimet e dhëna

Bordi i AKP-ës nuk kishte arritur të sigurojë një kornizë të përshtatshme ligjore e cila do të ofronte bazë të arsyeshme për një menaxhim të shëndoshë dhe efikas të Fondit të privatizimit. Mungesa e kësaj kornize është reflektuar edhe në kontrollin e brendshëm të Agjencisë i cili nuk

ka funksionuar në mënyrë të kënaqshme, duke mos arritur të siguroj një proces transparent të privatizimit.

Rekomandojmë Bordin Drejtues të AKP-ës që:

- Të krijoj një kornizë të plotë ligjore dhe kontrolle adekuate të brendshme të cilat do të sigurojnë menaxhim efikas dhe efektiv të Fondit të Privatizimit (Llogari të Mirëbesimit).

Unë rekomandoj Kuvendin që të:

- Ndjekë ngushtë mënyrën se si Qeveria, p.sh MEF-i e përmbush rolin e saj si përfaqësuese e pronarëve në NP;
- Konsiderojë masat që sigurojnë konsistencën mes kërkesave në LMFPP dhe Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike; dhe
- Konsiderojë një ndryshim të ligjit mbi NP-të duke siguruar se një përfaqësues nga pronari do të caktojë auditorë të jashtëm në ndërmarrjet individuale.

7 Institucionet e pavarura

Ne kemi audituar gjashtë institucione të pavarura për vitin buxhetor 2009:

- Agjencinë e privatizimit
- Ombudspersoni
- Agjencia kundër korrupsionit
- Këshillin gjyqësor
- Komision Qendror të Zgjedhjeve; dhe
- Akademinë e Shkencave dhe Arteve.

Institucionet e pavarura përballen me një numër sfidash të përbashkëta në lidhje me pavarësinë e tyre, llogaridhënien e tyre, dhe procesin buxhetor. Ato kryesisht ushtrojnë funksione mbikëqyrëse dhe rregullatore dhe mund të ndahen në dy lloje:

1) Institucionet që kryejnë funksione mbikëqyrëse dhe zakonisht nuk kanë burime të të hyrave vetjake, dhe
2) agjencitë e pavarura dhe zyre të rregullatorit që lëshojnë licenca dhe shpesh nga këto funksione ato mbledhin pagesa.

Të qenit i pavarur nuk do të thotë shmangie nga llogaridhënia, por nënkupton të qenit i pavarur nga ekzekutivi. Në shumicën e rasteve, këto institucione i raportojnë Kuvendit për rezultatet e tyre, i cili gjithashtu merr përgjegjësi për proceset e emërimit dhe garantimin e pavarësisë e tyre.

Sipas standardeve evropiane, kushtet themelore që kërkohen nga agjencitë e pavarura janë:

1. Pavarësia financiare;
2. Pavarësia nga emërimi dhe zotërimi; dhe
3. Pavarësia nga ndërhyrja në vendimmarrje.

1. Pavarësia financiare

Në mënyrë që të jetë me të vërtetë i pavarur, emërimi i bordeve dhe shefave të Agjencive duhet të jetë transparent dhe i bazuar në merita, përderisa anëtarët e bordit dhe stafi i një institucioni duhet të jetë në gjendje të punojnë pa frikën e largimit për arsye arbitrare ose politike.

Procesi i buxhetit vjetor të Qeverisë

Qeveria e Kosovës është nën presion të fortë nga Fondi Monetar Ndërkombëtar për të zhvilluar buxhet të balancuar vjetor. MEF-i në vitet e mëparshme ka mbajtur ose tërhequr financimin e buxhetuar të mëparshëm nga institucionet e pavarura në mënyrë që të mund t'i transferoj këto fonde tek ministritë ose agjencitë tjera.

Qeveria duhet t'i analiëzoj nevojat specifike të çdonjërës agjenci para se të caktohen kufijtë buxhetor. Institucionet, të cilat nuk gjenerojnë të hyra vetjake, përbëjnë vetëm një pjesë të vogël të buxhetit të Kosovës. Ato kanë kosto relativisht të ulët, në krahasim me funksionin jetik demokratik që e kryejnë përmes mbikëqyrjes së funksionimit të duhur të shumë institucioneve të tjera publike.

Për më tepër, pjesa dërmuese e stafit të këtyre institucioneve përbëhet prej profesionistëve. Zvogëlimi i buxhetit të tyre, së këndejmi mund të dëmtojë qëndrueshmërinë e tyre.

Një vështirësi shtesë me të cilën përballen organet e pavarura është, që ato aktualisht nuk kanë mekanizma institucional përmes të cilave të mund ta mbrojnë veten nga ndërhyrjet qeveritare në buxhetet e tyre.

I vetmi organ kompetent për të diskutuar propozimet për buxhetin e institucioneve të pavarura është Kuvendi i Kosovës. MEF-i duhet ta mbikëqyrë këtë proces vetëm nga pikëpamja teknike, ndërsa roli i Kuvendit është që të jap pëlqim për buxhetet e kërkuara. Kuvendi i Kosovës në vitet e kaluara ka luajtur rol të vogël në procesin e buxhetit, duke qenë i përfshirë vetëm në aprovimin formal të tij.

Alokimi i fondeve

Ka shembuj ku MEF-i nuk e ka alokuar shumën e tërësishme të buxhetit vjetor të kërkuar nga institucionet e pavarura. Kufizimet e tilla buxhetore e rrezikojnë rëndë qëndrueshmërinë e institucioneve të tilla. Për vitin 2009, AKK nuk kishte mundur ta shpenzoj Buxhetin për paga dhe mëditje për shumën prej afër 50,000€, përkundër buxhetit të aprovuar.

Sfidat Administrative

Shumica e institucioneve të pavarura janë të vogla. Në të njëjtën kohë ato i përmbushin të njëjtat kërkesa ashtu si edhe institucionet e tjera për sa i përket menaxhimit financiar dhe administrimit. Përmbushja e këtyre kërkesave dhe ruajtja e cilësisë së këtyre shërbimeve nuk është gjithmonë e lehtë. Për të paraqitur një numër të duhur të stafit mbështetës dhe cilësinë e duhur duhet të jetë një zgjidhje mjaft e kushtueshme.
Gjetja e mënyrës për të përdorur ekonominë e shkallës është një çështje me rëndësi.

2. Pavarësia nga emërimi dhe zotërimi

Në mënyrë që të jetë me të vërtetë i pavarur, emërimi i bordeve dhe shefave të Agjencive duhet të jetë transparent dhe i bazuar në merita, përderisa anëtarët e bordit dhe stafi i një institucioni duhet të jetë në gjendje të punojnë pa frikën e largimit për arsye arbitrare ose politike.

3. Pavarësia nga ndërhyrja në vendim-marrje

Institucionet e pavarura duhet t'i raportojnë drejtpërdrejt Kuvendit, e jo ndonjë Ministrie apo Qeverisë. Përderisa institucionet duhet të japin llogari për shpenzimet e fondeve të tyre publike, ato duhet të jenë të pavarura nga Qeveria në funksionin e tyre. Kjo do të thotë që linja parësore e llogaridhënies duhet të jetë para Kuvendit, si dhe institucionet duhet të jenë të lira nga kërkesat e raportimit tek Ministritë, që nuk janë të parashikuara me ligj.

Qeveria nuk duhet të ketë ndikim mbi vendimet që merren nga institucionet e pavarura.

Konkluzione dhe rekomandime

Organet e pavarura që ushtrojnë funksione mbikëqyrëse dhe rregullative janë thelbësore për ndërtimin e demokracisë në Kosovë. Pavarësia medoemos duhet të sigurohet në të njëjtën kohë kur edhe menaxherët duhet të japin llogari për mënyrën se si është ekzekutuar buxheti.

Rekomandim për Kuvendin e Kosovës të konsiderojë:

- Të luaj një rol më të madh në mbikëqyrjen e zbatimit të kornizës ekzistuese legjislative të institucioneve të pavarura;
- Të emëron me kohë bordet apo kryesuesit e institucioneve dhe të sigurohet që të kanë nivel të lartë të kualifikimit dhe të jenë të pavarur;
- Të merr rol më aktiv në shqyrtimin dhe miratimin e raporteve vjetore të institucioneve të pavarura;
- Të fillojë një studim për mënyrën se si të organizojë mbështetjen administrative për institucionet e pavarura duke siguruar cilësi në shërbimet administrative; dhe
- Të hartojë kornizën ligjore për institucionet e pavarura duke përcaktuar kriteret që garantojnë pavarësinë dhe duke specifikuar kërkesat e llogaridhënies.

Rekomandim për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave:

- Të respektoj pavarësinë e Institucioneve të Pavarura duke mos ndërhyrë në prioritetet operative apo proceset e tyre buxhetore. Kjo nënkupton bartjen e propozimeve buxhetore të këtyre institucioneve tek Kuvendi, ku Kuvendi mund të ushtrojë mbikëqyrje buxhetore dhe t'i mbajë ato përgjegjëse;
- Të ndajë shumën e plotë të buxhetit për institucionet e pavarura; dhe
- Të rikthejë /ruajë nivelin e personelit në institucionet e pavarura dhe të lejohen këto institucione të plotësojnë vendet e lira sipas atyre niveleve të planifikuara të personelit.

8 Komunat

8.1 Hyrje

Për vitin 2009, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka kryer auditimin e 33 komunave. Katër komuna (Prishtina, Prizreni, Zveçani dhe Leposaviqi) janë kryer nga ZAP, ndërsa 29 të tjera janë kontraktuar tek tri kompani private të auditimit (KPMG, Grand Thornton dhe Deloitte) si për nevojë të krahasimit të cilësisë edhe për shkak të mungesës së kapaciteteve audituese të ZAP. Duhet të theksohet fakti se Komuna e Leposaviqit nuk ka përgatitur Pasqyra Financiare si dhe ka refuzuar t'i nënshtrohet auditimit. Pra, ne nuk ishim në gjendje të kryejmë auditimin në këtë komunë.

Përgjegjësitë tona dhe ato të tre kompanive të angazhuara audituese ishin të shprehnim opinionin mbi pasqyrat financiare, të raportonim mbi cilësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.

Në raportet tona të auditimit, janë shprehur Opinionet përkatëse për Pasqyrat Financiare në përputhje me ISSAI 400. Përveç opinioneve, Auditimi i Pasqyrave Financiare të Komunave si shpenzues individual buxhetor, ka rezultuar me një varg gjetjesh dhe mangësish menaxheriale. Këto do të prezantohen në vijim.

Për herë të parë këto auditime janë kryer me kohë.

Bazuar në auditimet e kryera, informacioni në PF të shumicës së komunave nuk ishte i mjaftueshëm, i besueshëm, dhe relevant për të bazuar një opinion standard. Në shumë komuna ka ende shumë për tu bërëve qëllim që të ofrohet një cilësi më e mirë e raportimit financiar.

Në vitin 2009 janë nxjerrë 33 raporte të auditimit të komunave. Auditorët nuk kanë qenë në gjendje të japin opinion për 29 komuna, për shkak të mangësive substanciale të Pasqyrave financiare (**Mohim**). Opinione të ***Kualifikuara*** janë dhënë për dy komuna (Hani i Elezit dhe Juniku). Opinione të ***Pa kualifikuara*** janë dhënë në dy raste tjera (Prishtina dhe Prizreni). Pra, për shumicën e pasqyrave të komunave është dhënë *Mohim i Opinionit*. Opinione të njëjta ishin dhënë edhe gjatë vitit 2008. Dallimet në mes të opinioneve janë shpjeguar në shtojcën 1.

Mohimi i opinionit të auditimit ndodhë kur auditori nuk është në gjendje të jap një opinion mbi pasqyrat financiare të marra si tërësi, për shkak të një pasigurie apo një kufizimi të qëllimit aq thelbësor sa një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte, do të ishte i papërshtatshëm. Formulimi i një refuzimi të tillë bën të qartë se nuk mund të jepet një opinion, duke specifikuar qartë dhe shkurt çështjet e pasigurta.

Me të vërtetë, kjo situatë e vënë në rrezik reformën administrativë për sa i përket delegimit të zbatimit të politikave dhe mjeteve financiare tek komunat. Të gjeturat kryesore të auditimit të paraqitura më poshtë, i shtjellojnë më hollësisht këto fusha.

8. 2 Vetëqeverisja lokale dhe përgjegjësitë

Buxheti vjetor i komunës miratohet sipas ligjit të përvetësimeve buxhetore. Për ndarjen dhe menaxhimin e fondeve, nga komunat kërkohet që t'i përmbahen ligjit për buxhetin vjetor, dhe LMFPP-së.

Komuna dhe zyrtarët e saj ekzekutiv janë të autorizuar që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë të hyrat komunale dhe grandet operative. Burimet financiare të komunës – përveç granteve nga niveli qendror -përbëhen nga të hyrat nga tatimet, grantet operative, grantet për kompetencat e zgjeruara, grantet e jashtëzakonshme, ndihmat financiare nga Republika e Serbisë dhe përfitimet nga huadhëniet komunale.

MEF është përgjegjëse që t'u ndihmojë komunave të përmbushin obligimet e tyre buxhetore.

Raportet tremujore dhe raporti përfundimtar për buxhetin e komunës

Nga kryetari i komunës kërkohet që të përgatit raporte tremujore dhe ato t'ia dorëzojë Kuvendit të Komunës gjatë tërë një viti fiskal. Raportet e tilla i dorëzohen kuvendit të komunës, ndërsa një kopje i dërgohet Qeverisë. Këto raporte pastaj publikohen në ueb faqen e komunës. Çdo raport tremujor duhet të përmbajë raportin e të hyrave dhe shpenzimeve, informata për investimet dhe borxhet, si dhe një përmbledhje të gjendjes së të gjitha projekteve për shpenzime kapitale.

Kryetari i komunës përgatit dhe ia dorëzon Kuvendit të Komunës një raport përfundimtar të buxhetit për vitin e kaluar fiskal dhe për dy vitet e kaluara fiskale, i cili duhet të përmbajë informatat si vijon:

8.3 Financimi i komunave

Komunat janë financuar nga grantet qeveritare, të hyrat vetjake dhe donacionet. Shpenzimet totale të komunave për vitin 2009 ishin 263,397,207€. 21% e shpenzimeve totale të BKK-së janë bërë nga komunat. Financimi i komunave nga të hyrat vetjake llogaritet të jetë vetëm 18% nga financimi i përgjithshëm. Inkasimi i të hyrave vetjake dallon prej një komune në tjetrën dhe shkon nga 0% deri në 38%, të të hyrave të përgjithshme. Në total, të hyra vetjake janë mbledhur 48,293,000€.

Tabela 5 Komuna me përqindje më të lartë të burimeve vetanake

Komuna	Shpenzimet 2009	Të hyrat vetjake	% e shpenzimeve
Prishtina	47,520,812	18,301,000	38%
Fushë Kosova	4,569,899	1,125,000	24%
Ferizaj	14,262,384	2,965,000	21%
Hani i Elezit	1,209,145	217,000	18%
Klina	5,660,241	1,038,000	18%
Prizreni	23,411,442	4,342,000	18%
Gjilani	15,445,057	2,608,000	17%
Gjakova	13,662,885	2,316,000	17%
Lipjani	8,429,784	1,359,000	16%
Obiliqi	3,111,494	507,000	16%
Peja	13,998,573	2,283,000	16%

Tabela 6 Komunat me shkallë të ultë të të hyrave vetjake

Komuna	Shpenzimet 2009	Të hyrat vetjake	% e shpenzimeve
Malisheva	6,592,401	549,000	8%
Juniku	848,853	56,000	7%
Mamusha	721,335	32,000	4%
Shtërpca	1,649,223	74,000	4%
Novobërda	925,552	25,000	3%

Tri komunat e banuar me serbë (Leposaviqi, Zubin Potoku dhe Zveçani) nuk kanë mbledhur asnjë të hyrë nga aktivitetet e tyre.

Nga tabela më lartë shihet se komunat më të mëdha kanë përqindje më të lartë të të hyrave vetjake kundrejt shpenzimeve të përgjithshme.

8.4 Zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar

Tek komunat, të dhënat në lidhje me adresimin e rekomandimeve nga viti i kaluar janë shumë të mangëta. Auditimet e komunave të ZAP për vitin 2008 kanë rezultuar me 230 rekomandime të dhëna për 33 komuna (duke përjashtuar Leposaviqin). Sidoqoftë, gjatë vitit 2009 vetëm 40 nga këto rekomandime apo rreth 17% prej tyre janë zbatuar, ndërsa 190 apo rreth 83% të tyre nuk janë adresuar. Rekomandimet e dhëna kanë të bëjnë kryesisht me Përgatitjen e PF-ve, menaxhimin e pronës dhe pajisjeve, të hyrat dhe shpenzimet.

Është shqetësuese që zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar 2009 ka qenë vetëm 17%. Zbatimi i rekomandimeve nga viti i kaluar për vitin 2008 (dmth të rekomandimeve të vitit 2007) ishte 47%. Pak a shumë, të njëjtat problem si në vitet e kaluara mbeten edhe në vitin 2009. Mungesa e veprimeve për rekomandimet e viteve të kaluara flet për menaxhim të dobët financiar.

MAPL duhet të marrë masa në mënyrë që të adresoj këtë çështje. MAPL duhet që së bashku me MEF-in të analizojë arsyet pse rekomandimet e vitit të kaluar nuk adresohen dhe së bashku të përgatisin një program gjithëpërfshirës, i cili do të adresojë këto çështje.

8.5 Gjetjet kyçe të auditimit

Gjetjet kyçe të auditimit janë gjeneruar nga mangësitë e zakonshme substanciale në procesin e përpilimit të Pasqyrave të Konsoliduara. Këto mangësi në shumë raste kanë ndikuar në opinionet e auditimit.

Çështjet tjera ishin:

- Disa Komuna nuk kanë dorëzuar kontributet e tyre sipas datës së dakorduar, apo edhe nuk i kanë dorëzuar fare në MEF;
- Disa Komuna nuk kanë mbajtur regjistra të plotë kontabël dhe Pasqyrat Financiare është dashur të përgatiten duke përdorur Evidencat e Thesarit;
- Ka pasur mos shpalosje më të gjera, ose prezantime të mangëta të pasurive në vlerat e tyre financiare;
- Disa Komuna kanë raportuar pak ose nuk kanë raportuar fare të hyra vetjake në regjistrat kontabël;
- Nuk janë kryer shumë harmonizime të pritura në mes të hyrave të mbledhura me ato të regjistruara në llogari;
- Në përgjithësi, Komunat nuk kanë mbajtur lista të pagesave nga palët e treta;
- Në shumicën e komunave, trajtimi i pasurisë jo financiare nuk është në pajtim me standardet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr. 20/2009 për Regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive qeveritare;
- Trajtimi i prokurimeve në shumicën e komunave ende lë vend për përmirësime substanciale; dhe
- Mos formimi i komiteteve të auditimit në shumicën e Komunave.

Kërkesat ligjore mbi raportimin financiar

Komunat nuk kanë plotësuar shumë nga kërkesat ligjore mbi raportimin financiar. Për shembull:

- Vetëm dy komuna (Prishtina dhe Prizreni) i kanë përgatitur PF në pajtim me UA nr. 20/2009 mbi raportimin vjetor të Organizatave buxhetore
- Komuna e Zveçanit, Kamenicës, Leposaviqit, dhe Zubin Potokut nuk i kanë nënshkruar Pasqyrat e tyre financiare;
- Tri komuna (Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku) nuk kanë dorëzuar Pasqyrat e tyre financiare në MEF;
- 16 Komuna nuk kanë dorëzuar raportet financiare tremujore tek Ministri i MEF;
- Vetëm tri komuna kanë përgatitur PF-të e tyre në të dy gjuhët zyrtare (Kamenica, Novobërda dhe Shtërpca);
- 10 Kryetarë të komunave nuk kanë prezantuar Raportin përmbledhës buxhetor sipas nenit 46.1 të LMFPP-së nr. 03/L-048; dhe
- Vetëm14 komuna kanë përgatitur PF-të në

Përmbushja e kritereve për çertifikimin e komunave

- Vetëm tri komuna nuk kanë konfirmuar zbatimin e suksesshëm të përdorimit të modulit të blerjeve në Free Balance;

- Në dhjetë komuna, nuk është konfirmuar se Zyrtari i pranimit të mallrave, zyrtari i shpenzimeve dhe zyrtari çertifikues/aprovues i shpenzimeve janë çertifikuar nga MEF;
- Tri komuna nuk kanë konfirmuar implementimin e strukturës menaxhuese dhe organizative lidhur me shpenzimet Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku); dhe
- Në pesë komuna, zyrtarët përkatës nuk kanë ndjekur trajnimet mbi delegimin e menaxhimit të shpenzimeve nga MEF tek organizatat buxhetore.

8.6 Konkluzionet përfundimtare

Raportet tona përfshijnë rekomandime që ndërlidhen me të gjeturat e auditimit. Këto rekomandime supozohen të ndihmojnë komunat që të përmirësohen. Fatkeqësisht, shumica e rekomandimeve tona nuk po implementohen. Prandaj, dobësitë e njëjta po përsëriten nga viti në vit, duke rezultuar me përmirësim shumë të ngadalshëm të menaxhimin të financave publike.

Krahas mangësive menaxheriale, ekzistojnë dobësi të shumta në fushën e raportimeve nga ana e komunave.

Metoda dhe mjete të tjera duhet të merren parasysh për të siguruar një raportim të jashtëm dhe MFK më të mirë në komuna. Praktikat aktuale vejnë në rrezik efektivitetin e delegimit të fuqive.

Rekomandime

Në raportet individuale të komunave janë dhënë rekomandimet për të gjitha fushat përkatëse. Sidoqoftë, për të arritur tek një përmirësim i përgjithshëm i financave publike lokale, rekomandohet Ministri i MEF dhe Departamenti i Thesarit që:

- Të ndërmerr masa që të gjitha komunat t'i dorëzojnë Pasqyrat financiare brenda afateve ligjore, të plota dhe në pajtim me Udhëzimet Administrative të fundvitit. Vëmendje të posaçme duhet ti kushtohet gjetjes së një zgjidhjeje se si të inkurajohen komunat serbe për të dorëzuar raportet financiare;
- Komunat të vendosin një sistem që do merrej me regjistrim, vlerësim, zhvlerësim, huazim, vënien jashtë përdorimit të pasurisë;
- NJQH/AB të nxisë themelimin dhe funksionalizimin e Komiteteve të Auditimit në secilën Komunë;
- Departamenti e Thesarit të organizoj trajnime intensive mbi përpilimin e Pasqyrave financiare, (ngase asnjë komunë nuk ka përgatitur PF sipas UA).
- Departamenti e Thesarit të organizoj trajnime për komunat që nuk kanë ndjekur trajnimet lidhur me delegimin e menaxhimit të shpenzimeve;
- Të organizohen trajnime për komuna që nuk kanë konfirmuar zbatimin e suksesshëm të modulit të blerjes në Free Balance;
- Po ashtu, trajnimet të vazhdohen edhe me Zyrtarët e pranimit të mallrave, të shpenzimeve, zyrtarët çertifikues/aprovues dhe të njëjtit të çertifikohen nga MEF.

Shtojcat

1. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
2. Opinionet e Auditimit dhe mangësitë kryesore menaxheriale

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për VF 2009
(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:
    (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuara të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistonte (të qëndrueshme);
    (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
    (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
    (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksim i çështjes**. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifikë të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinioni. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund **të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar** kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

(a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
(b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustifikuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
(c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinioni i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinioni i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinioni që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restrikcionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinioni të tillë të kundërt e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca 2

Tabela: Opinionet e Auditimit dhe mangësitë kryesore menaxheriale

Subjektet e Audituara	Buxheti në mil. euro	Llojet e opinioneve	Arsyeja për kualifikimin e opinionit	Mungesat menaxheriale
Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit	161.0	*Opinion i pa kualifikuar*		Klasifikimi jo i duhur dhe mos harmonizimi rregullt i të hyrave; menaxhimi jo i mirë i pasurive; gjate vitit 2009 nuk ka pasur NJAB
Ministria e Ekonomisë dhe Financave	124.2	*Opinion i Pa kualifikuar*		Shpalosje jo e mirë e të hyrave(dividentës) në PF; Kontratat e punëmarrësve jo të rishikuar me kohë; Monitorimi i Ndërmarrjeve Publike lë vend për përmirësime; Mos-pajtueshmëri me LPP;
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	55.4	*Opinion i Pa kualifikuar*		Mos-pajtueshmëri me LPP; Shpalosje joadekuate e pasurive fikse; Dobësi në kontrollin e brendshëm; Kontratat për kryerjen e shërbimeve në kundërshtim me Rregulloret e Thesarit.
Ministria e Administratës Publike	33.5	*Opinion i Pa kualifikuar*		Mos-pajtueshmëri me LPP; Dobësi në: menaxhimin e pasurive, menaxhimin e listës se pagave, mbylljen e avanseve, sistemin e Kontrollit të Brendshëm; Mungesë e analizës së kost-benefitit të investimet kapitale ;Mungesë e ndarjes së detyrave.
Ministria Për Forcën e Sigurisë së Kosovës	21.8	*Opinion i Pa kualifikuar*		Shpenzim i ulët i buxhetit; Mos pajtueshmëri e plotë me LPP; Nuk ka pasur menaxhim adekuat të pasurive; Nuk ka funksionalizuar NjAB-në si dhe nuk ka themeluar Komitetin e auditimit
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	14.6	*Opinion i Pa kualifikuar*		Mos-pajtueshmëri me LPP; Nuk ka pasur menaxhim adekuat të pasurive; Nuk është bërë ndarja e duhur e detyrave të personelit menaxherial; NJAB nuk ka mbuluar vitin 2009;
Ministria e Pushtetit Lokal	11.8	*Opinion i Pa kualifikuar*		Mos kompletimin e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore.
Doganat	9.9	*Opinion i Pa kualifikuar*		Mbikëqyrje jo e duhur te depove doganore;mos argumentim i ndryshimit të bazës doganore te importeve; kontrolli I brendshëm dhe AB funksionojnë jo-kënaqshëm; mungon një regjistër i pasurive fikse sipas kërkesave të UA 21/2009; mos inkasimi I obligimeve tatimore gjatë importimit te mallrave; mungesa e një UA per strukturën organizative dhe raportimit te ZKF dhe certifikuesit të ZKA.
Kuvendi	9.6	*Opinion i Pa kualifikuar*		
Zyra e Kryeministrit	8.8	*Opinion i Pa kualifikuar*		Dobësi në zhvillimin e procedurave dhe ligjshmërisë së inkasimit të të hyrave; Kalkulim jo i saktë në aplikimin e taksave për shërbimet e kryera në AVUK; Mos-pajtueshmëri me LPP; Kontratat nuk përmbajnë çmimin për shërbimet përkatëse,

Administrata Tatimore e Kosovës	7.7	*Opinion i Pa kualifikuar*		Nivel i ulet i mbledhjes së taksave të planifikuara, dhe inkasim i ulet i borxheve; Dobësi në procesimin e të dhënave të tatimpaguesve në SIGTAS; Mos-pajtueshmëri me LPP; Kontrolle menaxheriale dhe financiare të pamjaftueshme.
Zyra e Presidentit	2.8	*Opinion i Pa kualifikuar*		Mos-pajtueshmëri me LPP; Dobësi në menaxhimin dhe evidentimin e pasurive; sistemi i Kontrollit te brendshëm jo i mjaftueshëm.
DANIDA	1.1	*Opinion i Pa kualifikuar*		Menaxhim jo i duhur i programit. me kontrolle të brendshme adekuate, si dhe përputhshmëri të pritur me kornizën e aplikueshme, duke ndikuar në implementimin e dobët të planit dhe buxhetit.
Akademia e Shkencës dhe Arteve	0.5	*Opinion i Pa kualifikuar*		Mos-pajtueshmëri me LPP; Shpalosje joadekuate e pasurive fikse; Dobësi në kontrollin e brendshëm.
Agjencia Kundër Korrupsion	0.5	*Opinion i Pa kualifikuar*		Mos pajtueshmëri me LPP; Mungesë e regjistrimit te pasurisë; Sistem i dobët i kontrollit të brendshëm.
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	163.5	*Opinion i Pa kualifikuar*		Shpalosje joadekuate e pasurive fikse; dobësi në kontrollin e brendshëm; Mos-mbyllja e avanceve.
Ministria e Shëndetësisë	78.1	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Pasuritë fikse nuk janë shpalosur plotësisht në PF	Mos përgatitja e PF ne pajtim me UA 20/2009; mungesa e kontrollit te brendshëm; çertifikimi i parregullt i pagesave; Mos pajtueshmëri me LPP.
Ministria e Punëve të Brendshme	76.8	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Të Hyrat vetjake nuk janë regjistruar në kode adekuate ekonomike dhe Pasuritë fikse nuk janë shpalosur	Mos-pajtueshmëri me LPP; Parregullsi në aktivitetin rreth furnizimit me karburante.
Prishtinë	60.3	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Te ardhurat vetjake te cilat janë bartur nuk janë shpalosur si duhet; Pasurit fikse nuk janë shpalosur sipas kërkesave ligjore; dhe Detyrimet e papaguara nuk janë prezantuar.	Nuk janë bërë harmonizime të të hyrave ndërmjet departamenteve dhe Drejtorisë së financave; Shpenzimet për mëditje të delegatëve dhe komisioneve në vitin 2009 kanë qenë 281,029€ ose 335% më shumë se në vitin paraprak 2008. Pa pajtueshmëri me LPP; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse si dhe një regjistër kontabël; Mungojnë procedurat formale për të regjistruar provizionet për detyrimet kontingjente.
Ministria e Punëve të Jashtme	24.8	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Pasuritë fikse nuk janë shpalosur	Mos shpalosja e pasurive fikse; Marrja e objekteve me qira për ambasada dhe blerja e automjeteve është bërë në kundërshtim me LPP; Mos përgatitja e raporteve financiare me kohë dhe të kompletuara nga Shefat e Misioneve Diplomatike;
Prizren	24.4	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Mungesë e listës për pagesat e bëra nga palët e treta dhe informatat shtesë për të pagueshmet, arkëtueshmet dhe pasuritë tjera të përcaktuara si pasuri jo financiare; dhe Në shënimin 27 të PF, Komuna nuk kishte shpalosur një regjistër gjithëpërfshirës mbi pasuritë	Kontrollet të pamjaftueshme në lidhje me të hyrat vetjake të Komunës; Avanset për udhëtime zyrtare janë menaxhuar në mënyre joadekuate; Mangësitë e vërejtura në lidhje me kontrollet e brendshme për sa i takon prokurimeve; Detyrimet e pa paguara në afatin e përcaktuar kohor; Nuk është bërë shpalosja e vlerës së pasurisë fikse në PF; Funksioni i Auditimit të Brendshëm ka nevojë për forcim.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	15.4	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	jo financiare Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme ne PF nuk përputhet me pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit për 90,000€; tabela e të hyrave nuk është plotësuar dhe nuk ju ka bashkëngjit PF, si dhe nuk është bërë shpalosja e pasurisë fikse në mënyrë të duhur.	Mos-harmonizim me LPP-në; Regjistri i pasurive nuk është i plotë dhe i saktë; Kontroll i dobët I brendshëm.
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	12.2	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Individët e angazhuar me kontratë për kryerjen e shërbimeve paguhen nga subvencionet dhe transferet.	Mos-pajtueshmëri me LPP; kontrolli i brendshëm i dobët; pagesa të pa rregullta ,xhirollogari te hapura pa autorizimin e thesarit;mosparaqitja e drejt e pasurive ne PF
Agjencia Kosovare e Privatizimit	12.2	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	mungesa e dorëzimit të të gjitha raporteve që kërkohen me marrëveshjen për monitorim dhe kontroll nga ana e pjesës veriore të N.SH. Trepça	sistem të kontrollit të brendshëm jo funksional; dobësitë në menaxhimin e shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve, investimeve kapitale, menaxhimin e personelit si dhe menaxhimin e pasurive
Kompania Regjionale e Ujërave Sh.A "Prishtina", Prishtinë	10.6	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Mungesa e një politike për njohjen e provizioneve për borxhe te këqija dhe te dyshimta. 80 % e mjeteve te pa inkasuara janë provizionuar si borxhe të këqija dhe te dyshimta.	Mungesa e një kornizë të brendshme ligjore, si dhe manuale të shkruara të cilat do të ofronin bazë të nevojshme për një menaxhim të shëndoshë dhe efikas të kompanisë; dobësi në menaxhimin me të hyrat, shpenzimet, menaxhimin e parasë, menaxhimin e pasurive dhe sistemin e kontrollit të brendshëm.
Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë	9.2	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Pasuritë fikse nuk janë shpalosur ne PF	Pasuritë fikse nuk janë regjistruar ; Mos-pajtueshmëri me LPP; Kontrolli i brendshëm i dobët;
Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	9.1	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes		Mos-pajtueshmëri me LPP; Subvencionimi i OJQ-ve pa konkurse dhe pa aprovimin e projektit nga komisioni përkatës; çertifikimi i pagesave të parregullta.
Ministria e Energjisë dhe Minierave	2,2	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Pasuritë fikse nuk janë shpalosur në mënyrë të plotë në PF.	Regjistri i pasurive nuk është i plot dhe i saktë; Mos-pajtueshmëri me LPP; Mangësi ne sistemin e kontrollit te brendshëm.
Avokati i Popullit	0.5	Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Mos prezantim të donacioneve në PF.	Sistemi i dobët i kontrollit të brendshëm; Mungesa e politikave dhe procedurave të brendshme gjatë 2009.
Agjencia Kosovare e Privatizimit – Fondi i Privatizimit		Opinion i pa kualifikuar me Theksim të çështjes	Mungesa e sigurimit të kornizës rregullative për formën e raportimit të PF të Fondit të Privatizimit	Menaxhim i dobët në përmbylljen e kontratave duke shkaktuar zvarritje të pa arsyeshme; menaxhim jo të mirë në monitorimin e Ndërmarrjeve të cilat ishin Privatizuar me Spin-Off special; Kundërthëniet në mes të politikave operacionale të AKP-së dhe rregullave të tenderit; dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Ministria e Drejtësisë	23.1	Opinion i Kualifikuar	Prezantimi i Investimeve Kapitale si Fitimi nga shitja e pasurisë dhe diferenca në mes të vlerës të pasurive jo financiare të prezantuara në PF dhe SIMFK	PF nuk janë përgatitur sipas UA; Mos-pajtueshmëri me LPP; Inventarizimi i pasurisë nuk është i kompletuar; dhe rekomandimet e NjAB nuk janë zbatuar.
Komisioni Qendror Zgjedhor	8.4	Opinion i Kualifikuar	Mos-shpalosja e depozitave të pranuara nga subjektet politike; shpenzimeve të paguara nga donacioni dhe pasurive në PF	Pasuritë e blera gjatë vitit 2009 nuk janë regjistruar; mos respektimi i procedurave të prokurimit; mos themelimi i NJAB
Hani i Elezit	1.4	Opinion i Kualifikuar	Komuna nuk e ka mbajtur listën e pagesave nga palët e treta; mungon një regjistër gjithëpërfshirës i pasurive.	Burimi i informacionit për përgatitjen e PF është Free Balance; Komuna nuk ka zbatuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës;Mungon lista e pagesave nga palët e treta; dhe nuk ka kryer ndonjë proces formal që mund të sigurojë informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizoreve dhe detyrimeve kontingjente.
Junik	1.0	Opinion i Kualifikuar	Mungesë e dokumenteve mbështetëse në lidhje me pagesat nga palët e treta; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore.	Mungesë e zbatimit të një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Nuk është themeluar NJAB dhe komiteti i auditimit të brendshëm.
Gjilan	16.4	Mohim i Opinionit	Mos përgatitja e PF ne pajtim me UA ; Regjistri i mjeteve themelore nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.	Pasqyra e ekzekutimit të buxhetit është jo-komplete dhe të hyrat në Pasqyrën e Pranimeve sipas Departamenteve nuk përputhen me "Pasqyrat e Pranimeve dhe Pagesave me Para të Gatshme" sipas ekzekutimit të buxhetit; dhe ka dështuar në zbatimin e procedurave të LPP.
Ferizaj	15.4	Mohim i Opinionit	Mos përgatitja e PF ne pajtim me UA; Regjistri i pasurive fikse nuk është ne harmoni me kërkesat ligjore.	Janë identifikuar diferencat e regjistruara në PF; nuk ka themeluar Komisionin e Auditimit ; Mos-pajtueshmëri me LPP
Pejë	15.4	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet shpjeguese; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore; Informacionet krahasuese për vitin 2008/2007 nuk janë komplete	Mos zbatimi i një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungon lista e pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP-në; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Fatura të papaguara në vlerë prej 5,500 euro nuk ishin përfshirë në listën e faturave të papaguara të shpalosura në PF; Mos themelimi i Komitetit të Auditimit të brendshëm.
Mitrovicë	14.4	Mohim i Opinionit	PF nuk janë komplete në formën dhe përmbajtjen e tyre siç kërkohet me UA ; Regjistri i pasurive fikse nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.	Të hyrat e prezantuara në PF dhe atyre të prezantuara në Free Balance, kanë një diferencë ; Nuk ka shpalosje të pasurive fikse në Pasqyra siç kërkohet UA; dhe pa pajtueshmëri me LPP.

Gjakovë	14.2	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet lidhëse; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore; Informacionet krahasuese per vitin 2008/2007 nuk jane komplete.	Mungesë e zbatimit të një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Nuk është themeluar Komiteti i Auditimit të brendshëm.
Podujevë	12.0	Mohim i Opinionit	Mungojnë disa shënime të kërkuara sipas SNKSP; mungon lista e pagesave nga palët e treta.	Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance; Nuk ka zbatuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës; Nuk ka mbajtur lista të pagesave nga palët e treta; papajtueshmëri me LPP; nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.
Vushtrri	9.5	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet shpjeguese; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse.	Mos zbatimi i një sistemi - faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Nuk është themeluar Komiteti i Auditimit të brendshëm.
Lipjan	9.2	Mohim i Opinionit	Mos ofrimi i dokumenteve mbështetëse në lidhje me pagesat nga palët e treta; Mos shpalosje në PF e ndonjë shume lidhur me pasuritë fikse.	Burimi i informacionit për përgatitjen e PF është Free Balance; Nuk ka zbatuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës; Pa pajtueshmëri me LPP; nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente. Mos formimi i komitetit te Auditimit
Suharekë	9.0	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet shpjeguese; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore;	Mungesë e zbatimit të një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungon lista e pagesave nga palët e treta; Mos-pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.
Gllogoc	7.4	Mohim i Opinionit	Mos ofrimi i dokumenteve mbështetëse në lidhje me pagesat nga palët e treta; Mungesa e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore; Mos përputhje e të ardhurave ndërmjet të dhënave sic janë llogaritur në sistemin e kontabilitetit dhe PF të shpalosura në fund të vitit.	Burimi i informacionit për përgatitjen e PF është Free Balance; Mos zbatimi i një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.
Rahovec	7.4	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet lidhëse; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore; Nuk janë bere shpalosjet e kërkuara sipas SNKSP; Mungesë dokumentacioni për të hyrat e realizuara.	Mos zbatimi i një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungon lista e pagesave nga palët e treta; Mos-pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.

Skenderaj	7.0	Mohim i Opinionit	Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; dhe Nuk janë shpalosur në PF shumat për pasurinë fikse.	Burimi i informacionit për përgatitjen e PF është Free Balance; Nuk është zbatuar një sistem i faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Nuk ka krijuar një Komitet Auditimi; dhe pa pajtueshmëri me LPP Nr. 2003/17
Malishevë	6.8	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet shpjeguese; Mungesë e regjistrit të pasurive sipas kërkesave ligjore; Informacionet krahasuese për vitin 2008/2007 nuk janë komplete	Mos zbatimi i një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Mos formimi i NJAB komitetit te auditimit të brendshëm; Mos ofrimi i dokumenteve të mjaftueshme që lidhen me pagesat e bëra për kompensime të stafit në Dhjetor 2009.
Viti	6.7	Mohim i Opinionit	Mos përgatitja e PF ne pajtim me UA ; dhe Regjistri i pasurive fikse nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.	Diferenca të pa barazuara në mes të shumave të regjistruara në Nenin 10 " Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit" të Pasqyrave dhe shënimet të këtyre pasqyrave të shpalosura në Nenin 11 "Shpalosja e shënimeve"; dhe pa pajtueshmëri me LPP.
Kamenicë	6.5	Mohim i Opinionit	Mos përgatitja e PF ne pajtim me UA ;dhe Regjistri i mjeteve themelore nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.	Diferenca të pa barazuar në mes të të hyrave të prezantuara në PF dhe atyre të prezantuara në Free Balance; dhe papajtueshmëri me LPP.
Klinë	5.9	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shenimet shpjeguese; mungon një regjistër i pasurive fikse sipas kërkesave ligjore; Informacionet krahasuese per vitin 2008/2007 nuk jane komplete.	Mos zbatimi i një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka infomacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontigjente; Ne kemi vërejtur se komuna raportoi detyrime (fatura të papaguara) prej 755 mijë Euro më datë 31 dhjetor 2009, që kur u shtohen shpenzimeve të komunës prej 5,892 mijë Euro e tejkalojnë buxhetin e aprovuar vjetor prej 341 mijë Euro; Nuk është themeluar Komiteti i Auditimit të brendshëm.
Istog	5.7	Mohim i Opinionit	Komuna nuk ka mbajtur listën e pagesave nga palët e treta; dhe nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve të saj.	Burimi informacionit për përgatitjen e PF është Free Balance; Mungesë e zbatimit të një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; pa pajtueshmëri me LPP ;dhe Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.
Fushë Kosovë	5.1	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet shpjeguese; mungon regjistri i pasurive.	PF nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet shpjeguese; Komuna nuk mbanë një regjistër të pasurive.
Deçan	4.7	Mohim i Opinionit	PF në disa pjesë nuk janë të plota dhe nuk barazohen me shënimet shpjeguese; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore.	Mungesë e zbatimit të një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Nuk është themeluar Komiteti i Auditimit të brendshëm.

Kaçanik	4.2	Mohim i Opinionit	Komuna nuk ka mbajtur listën të pagesave nga palët e treta;dhe nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pasurive.	Burimi i informacionit për përgatitjen e PF është Free Balance; nuk ka zbatuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës; dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta për të gjithë debitorët e saj për detyrime të lidhura me taksa të ndryshme dhe janë identifikuar një numër mos përputhjesh me LPP.
Dragash	4.1	Mohim i Opinionit	Mungesë e listës së detajuar të pagesave nga palët e treta; Mungesë e regjistrit të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore.	Burimi i informacionit për përgatitjen e PF është Free Balance; Mos zbatimi i në sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Mos formimi i komitetit të Auditimit.
Obiliq	3.7	Mohim i Opinionit	Mos përgatitja e PF ne pajtim me UA ; Regjistri i pasurive fikse nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.	Janë identifikuar diferenca të pa-barazuara që janë regjistruar në PF; Komuna ka dështuar në zbatimin e procedurave të prokurimit.
Shtime	3.5	Mohim i Opinionit	Nuk janë ofruar dokumente mbështetëse lidhur me pagesat nga palët e treta; Pasuritë fikse nuk janë shpalosur sipas kërkesave ligjore;	Mungon zbatimi i një sistemi faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungon lista e pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Mos formimi i komitetit te auditimit.
Leposaviq	2.1	Mohim i Opinionit	Nuk është lejuar kryerja e auditimit për vitin 2009	Komuna nuk ka përpiluar PF për fund vitin që mbaron me 31.12.2009;
Shtërpcë	1.7	Mohim i Opinionit	Mos përgatitja e PF ne pajtim me UA; dhe Regjistri i pasurive fikse nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.	Nuk ka shpalosje të mjeteve themelore në Pasqyra siç kërkohet me UA; dhe pa pajtueshmëri me LPP.
Zubin Potok	1.5	Mohim i Opinionit	Komuna nuk i ka përgatitur dhe paraqitur PF për vitin 2009.	Mungesë e regjistrit të të dhënave kontabël për të hyrat vetjake; Nuk mbanë regjistra të pasurive fikse sipas kërkesave ligjore; dhe pa pajtueshmëri me LPP.
Zveçan	1.4	Mohim i Opinionit	Nuk i ka përgatitur PF për fund vitin 31 dhjetor 2009; Nuk mban regjistra kontabël për arkëtimin e të hyrave vetjake;	Ka mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm sidomos tek verifikimi i faturave dhe dokumenteve përcjellëse; I mungon regjistri i pasurisë dhe dokumente mbi menaxhimin e pasurisë; Pa pajtueshmëri me LPP; NjAB nuk është formuar; mungojnë listat e pagave dhe dosjet e punëtorëve.
Novo Bërdë	1.1	Mohim i Opinionit	Mos përgatitja e PF ne pajtim me UA ; Regjistri i pasurive fikse nuk është në përputhje me kërkesat ligjore.	Mos-ekzistenca e dokumentacionit të shpenzimeve për paga; dhe mos pajtueshmëri me LPP.

Mamushë	0.8	Mohim i Opinionit	Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Mungesë e shpalosjeve të ndonjë shume për pasuritë fikse.	Burimi i informacionit për përgatitjen e PF është Free Balance; Mos zbatimi i një sistemi të faturimit automatik dhe gjithëpërfshirës; Mungesë e listës së pagesave nga palët e treta; Pa pajtueshmëri me LPP; Nuk ka informacione të plota dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente; Mos formimi i NJAB dhe komitetit të auditimit të brendshëm; Mungon zyrtari certifikues për regjistrimin e të dhënave kontabël në SIMK.
Universiteti i Prishtinës	22.7	Opinion i Kundërt	Harmonizimet jo te plota ndërmjet UP me njësitë akademike dhe BQK; Mungesa e regjistrimeve kontabël te të hyrave; Pasuritë fikse nuk janë paraqitur drejt ne PF	PF nuk janë përgatitur sipas UA; Mos-pajtueshmëri me LPP; Dobësi në kontrollin e brendshëm.
Ministria e Bujqësisë, Pulltarisë dhe Zhvillimit Rural	13.3	Opinion i Kundërt	PF janë jo të plota dhe pjesërisht çorientuese	PF nuk janë përgatitur sipas UA; Mosbarazimet e të hyrave; Mos-pajtueshmëri me LPP; Regjistri i pasurive nuk është i plotë dhe i saktë; kontroll i dobët i brendshëm; Dobësi ne menaxhimin e Subvencioneve.
Radio Televizioni i Kosovës (RTK).	10.2			Mungesa e plote e implementimit të rekomandimeve të ZAP në raportin e auditimit të PF të vitit 2008.
Ngrohtorja e Qytetit (Termokos) Sh.A. , Prishtinë	6.7			Mos respektim i kontratës për furnizim me mazut; mungesë e sistemit për me pasuri fikse. Ndarje e paqartë e detyrave. Shuma e faturuar nuk është barazuar me sistemin kontabël. Mospajtueshmëri me ligjin e prokurimit publik. Mungesa e politikave të qarta për shpenzimin e derivateve nga veturat.
Total i	**1258.7**			**15 Opinione të Pa kualifikuara, 16 të Pa kualifikuar me theksim të çështjes, 4 opinione të kualifikuara, 29 Mohim të Opinionit, dhe 2 Opinione të Kundërta**

Dizajni, faqosja dhe shtypi "**Studio FORMA**" Prishtinë

Për informata të mëtutjeshme, ju lutem kontaktoni:
Za više informacija, molimo vas kontaktirajte:
For further information, please contact:

Ilire Daija – Buza
ilire.daija@oagks.org
+381 (0) 38 25 35 121

Qëndresa Mulaj
qendresa.mulaj@oagks.org
+381 (0) 38 25 35 262

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Adresa: Rr. "Musine Kokollari", nr 16
10000 Prishtinë, Kosovë

Telefon : + 381 (0) 38 25 35 217
Faks: + 381 (0) 38 25 35 122

http://www.ks-gov.net/oag